




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 02.10.2018



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 02.10.2018
PRILJENO:
Nr.No.Br. 02/384

PROCESVERBAL

i mbledhjes së IX-të (e nëntë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e II dhe IV të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.
2. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/156 datë: 22.05.2018 të Kryesuesit të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale, për vitin 2017 (Janar-Dhjetor 2017).
4. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2018.
5. Shqyrtimi i mundësisë për caktimin e hapësirave për zyrën e kryesuesit të Kuvendit dhe të grupeve politike në Kuvendin e Komunës së Malishevës.
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1231 datë: 23.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.01/1116 datë:27.07.2018 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të z.Aziz Januzaj nga fshati Senik KK.Malishevë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/253 datë: 03.07.2018 të parashtruar nga z. Sadik Bytyqi nga fshati Millanoviq, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
9. Emërimi i anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore.
10. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1228 datë: 22.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për themelimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës.
12. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor Janar-Qershor 2018 të punës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

13. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
14. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.
15. Debat rreth raporteve të bashkëpunimit të Qeverisë Komunale dhe Kuvendit të Komunës.
16. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/179 datë: 11.06.2018 i parashtruar nga kryesia e fshatit Bubavec (e përsëritur).
17. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/244 datë:29.06.2018 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-807/6 datë:16.07.2018.
18. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/274 datë:13.07.2018 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale KEDS-it në fshatin Terpezë për qëllime të infrastrukturës energjetike, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-860/1 datë: 20.07.2018.
19. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për caktimin e javës së Diasporës.
20. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 13.06.2018 dhe filloi në ora 13:15 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 22 asambleistë, Nënkryetari media dhe qytetarë.

Rrahim Morina: Përshëndetje për të gjithë! Të pranishëm jemi 25 asambleistë dhe me këtë e hapi mbledhjen e IX të rregulltë për këtë vit. Si çdo herë e hapi debatin para rendit të ditës, a dëshiron dikush fjalën?

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë! Rruga Kjevë-Malishevë është shqetësim i yni dhe është bërë e padurueshme dhe kam një pyetje për Nënkryetarin, mbase Kryetari nuk është këtu. Nënkryetar, nuk e di se çfarë bashkëpunimi keni me Ministrinë e Infrastrukturës por firma që e ka këtë rrugë ka hapur gropa të reja gjatë gjerjes së asfaltit dhe ka krijuar shumë probleme për qarkullim të automjeteve madje ka pas edhe aksidente. Duhet ta keni parasysh që kjo rrugë i lidh dy autostrada dhe dua ta di që a ka ndonjë sinjal që kjo rrugë do të shtrohet së shpejti?

Hashim Vrenezi: Përshëndetje për të gjithë! Kam disa shqetësime që i drejtohe Kryetarit. Një shqetësim është nga banorët e fshatit Marali, përkatësisht lagjia “Bekolli” për rrugën “Luftëtari” e cila është buxhetuar për vitin 2018 por akoma nuk kanë filluar punimet. E di që rruga është e tenderuar, por nuk e di se cila është arsyeja se pse nuk fillojnë punimet në këtë rrugë?! Shqetësimi im është për punimet në rrugë dhe trotuarin në rrugë Dragobil-Marali që kanë filluar më shumë se dy muaj, në kohën e mërgimtarëve dhe kanë shkaktuar një kaos në trafik e së bashku me mërgimtarët për më tepër se dy muaj ne i shatërruam veturat tona nëpër ato gropa dhe ngushtica të rrugës gjatë punimeve të trotuarit. A ka Plan të Punës qeveria juaj dhe a ka mbikqyrje të punimeve? A kanë guxim ata mbikqyrës që të marrin masa ndaj punëkryrësve për punë jo kualitative? Nuk beosj që kanë guxim sepse

janë të shantazhuar, të blerë dhe të manipuluar nga qeverisja juaj. Kjo është për të ardhur keq se si është duke u keqpërdorur paraja publike në komunën tonë!

Një gjendje të keqe e ka edhe minitransiti i cili është shtruar para pak kohësh dhe ka pasur nevojë të intervenohet për një kohë shumë të shkurtër, të mbyllen gropat. Kur janë mbyllur grobat përsëri gjendja është e keqe sepse ato gropat nuk janë mbyllur në cilësinë e duhur. Është e tmerrshme që në një projekt kapital të intevenohet aq shpejt.

Pse Komuna jonë ka nevojë për të shtruar dhe rrafshuar asfaltin me bager ku kjo nuk ndodh në asnjë shtet tjetër të botës që asfalti të rrafshohet me bager. Çfarë cilësie mund të ketë ai asfalt?! Unë kam kërkuar nga Kryetari që të forcojë sistemin, të largojë të korruptuarit dhe të kryhen projektet kapitale në afat kohor.

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë! Kryetari Begaj në çdo fushatë e ka premtuar shtrimin e rrugës “Agim Çela” dhe kurrë nukëshzë shtruar ku janë diku 1400-1500 m rrugë. Nuk e di se si mund të thirret në emër të kësaj qeverie se ku ka shkelur këmbë e ushtarit do të shtrohet asfalt, por jo edhe kjo rrugë.

E dyta, te kanalizimi në një lagje të Lladrocit është dasht të intervenohet edhe pse e kam kërkuar në mbledhjen e kaluar por ju nuk keni intervenuar. Mbi atë kanalizim nxënësit kalojnë, edhe pse ne kemi kërkuar të mbartet më poshtë.

Prerja e asfaltit nëpër rrugë është shqetësimi tjetër, rrugët janë vështirë të kalueshme. Nuk e di pse ai që e merr tenderin nuk i shtron menjëherë kur prehet asfalti? Dilni dhe shiheni gjendjen në terren.

Hidajete Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Kam disa çështje që janë shqetësuese për qytezën e Malishevës siç është minitransiti që për çështjen e gropave e kemi diskutuar këtu, por asgjë nuk është bërë. Aty rruga është bërë si në Prishtinë në vitin 2000-2001 që ma mirë është të ecësh në këmbë se sa me veturë. Unë kam menduar që ky tranzit do të jetë në nivel, mirëpo rruga është e pakalueshme sepse nuk keni qenë në gjendje që as ato tuba dheu afër urës t’i pastroni e disa nga gropat t’i mbuloni.

Shqetësimi tjetër është për rrugën nga “Kastrati” që ka filluar të shtrohet e që e shkarkon komunikacionin nga qyteza deri Banjë. Më vjen mirë që kjo rrugë ka filluar të shtrohet, por është ndërprerë duke i favorizuar disa qytetarë duke ju shtruar kubëzat. Është mirë që njëherë të përfundoj rruga sepse aty duhet të ndërtohet edhe një urë sepse në lagjen tonë kalon një lum e që gjatë verës pakësohet uji. Prandaj më lehtë ndërtohet ura dhe nuk do të ketë shprehime si te ura e minitransitit.

Leonitë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë! Unë do të paraqes një shqetësim timin dhe të fshatit Turjakë në lidhje me gjendjen e kanalizimit i cili është në gjendje të mjerueshme dhe kërkon një intervenim urgjent nga Komuna sepse të gjitha ujërat e zeza derdhen në sipërfaqën e tokës, madje ka raste kur ato derdhen edhe para shtëpive. Në përgjithësi në fshat gjendja e kanalizimit është shumë e keqe por më keq qëndron në lagjen time. Me sa kan njohuri, kanalizimet e lagjeve nuk janë të lidhura me kolektorin kryesor, andaj e nderuara Qeveri Komunale kjo gjendje e tillë është e padurueshme dhe duhet një intervenim urgjent. Mbase Kryetari nuk është këtku kam një kërkesë për Nënkryetarin. Dua të di për tenderin që është hapur dhe është mbyllur në lidhje me kanalizimin dhe dua një sqarim se a është i përfshirë i gjithë fshati në këtë projekt?

Ilaz Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Në fshatin Carrallukë ka dy javë që nuk ka ujë të pijshëm. Uji keqpërdoret në vende tjera si pastrim i trotuarëve e ku ta di unë, kurse në Carrallukë nuk ka ujë të pijës fare.

Rruga Malishevë-Kjevë është shqetësim i shumë qytetarëve sepse përveç që kanë qenë disa gropa aty edhe është gryer asfalti në tërësi duke e prishur edhe më shumë rrugën dhe dëmton automjetet.

Kanalizimi në fshatin Carrallukë është bërë diku në vitin 2015 dhe është më së paku hera e 15-të që intervenohet aty. Ka dëmtim të pronave, të ujit të pishëm në fshat nga ky kanalizim për shkak të cilësisë së dobët të tij.

Këto janë shqetësimet që pata dhe kërkoj që të mirren masa për të gjitha këto që përmenda.

Alban Krasniqi: Këtu u përmendën shuëm çështje edhe të nivelit lokal edhe atij qendror, dhe zgjidhja e vetme janë zgjedhjet e reja si atje, si këtu. Këtu edhe më keq se s'po e lënë Kryetarin me ardh, kanë vendosur që Ragipi s'ka me qenë kryetar me gjasë Hajdini do të jetë kandidat për kryetar nëse nuk e kanë bërë një pazar tjetër. Definitivisht kjo mungesë e Kryetarit është njëfarë pamundësi i ushtrimit të detyrës së tij.

Kam një çështje që ka të bëjë me Ekoregjionin. Para disa ditësh kam marrë një shqetësim prej qytetarëve të lagjës "Mirëdita" se po derdh deponia e bërlllogut andej në emër të një selektimi që po e ja bëjkan për skaj rrugës të minitransitit. Unë isha duke monitoruar rrugën dhe e shoh kamionin e Ekoregjionit duke e derdh bërlllogun aty. Kam një pyetje Nënkryetar, a ka leje Ekoregjioni aty, e nëse ka a mundeni ta revokoni për të derdhur bërlllogun aty në emër të një selektimi? Jam i sigurtë që nuk ka leje sepse atë leje e lëshon vetëm Kuvendi Komunal. Kërkoj prej Komunës që t'i kryen minimalisht detyrat e saj, të dërgoj inspektorët përkatës e ta ndalojnë hedhjen e mbeturinave aty dhe të dënojnë kompaninë aq sa e meriton për ndotjen që është duke e bërë në Malishevë.

Dje e pash në shpalljen e Komunës që për mua është skandal 48,000€ ju kishin nda një organizate joqeveritare "Malasi" në emër të ofrimeve të shërbimeve për biznes. Shikova edhe shpalljet por nuk pash askund për OJQ për të mbajtur trajnime të biznesit. Po i lexoj anëtarët e komisionit: Ali Krasniqi, Hatixhe Bashota, Shyhrete Morina, Amrush Elashani NISMA dhe Haxhi MazrekuNISMA sigurtë. Ju garantoj që kam me ndjek këtë punë deri në detaje dhe kam dërguar në prokurori këtë çështje sepse kjo është shpërlarje e parasë publike. Gjithë këto para në emër të trajnimeve në fushën biznese. A thua bizneset tona nuk dinë të kryejnë shërbime a? E tani paskemi nevojë për një vajzë Adelina Berisha e që paska kapacitetin aq të madh profesional me grupin e Daut Krasniqit dhe bizneseve që këtu funksionojnë ne me i dhanë këto pare. Ne qytetarët hajme kashtë e ju vazhdoni disa zyrtarëve me ju mbush xhepat. Këto janë parat tona, nëse gjykata nuk intervenon, intervenon qytetari me votën e tij dhe s'ka vend për juve më. Ju lutem mos u tallni me neve, mos na trajtoni si gja të gjalla sepse bumerang do t'ju kthehet!

E treta, tri çështje janë në OSHP që përmenden. Nuk është e vërtetë që paramase dhe paralogaria janë mirë, nuk është hiç e vërtetë që procesi për minitransitin ka shkuar mirë. Është i qartë vendimi i OSHP-së i një pale ku 30% çmimi është më i lirë se sa çmimi i tregut se sa vlera që ka qenë aty. Kjo tregon që kompania për kryerjen e punëve është joserioze sepse me këtë çmim s'ka mundësi me u rregullu një projekt i tillë. OSHP-ja ndër të tjera ka thënë se është e tyre që Kuvendi Komunal me vendos kur e shohin që çmimi është joserioz ata duhet të ndërmarrin masa. Relativiteti tregon që Komuna s'ka ndërmarrë masa sepse ka marrë pare.

Fusha e futbollit njëjtë ka qenë në OSHP dhe ajo e ka dhënë përgjigjen pjesërisht për shkak të kualitetit dhe çmimit. E keni parë gjendjen aty.

Spërkatja e rriqërave, e keni projektin që kanë nënshkruar zyrtarët komunalë dhe rekomandim i OSHP-së ka qenë që të merren masa nga Komuna ndaj zyrtarëve që kanë nënshkruar kontratë për spërkatjen e rriqërave me një kompani “Beli” e cila se ka pasur në detyrë. Ju i keni shfrytëzuar krejt këta mekanizma për të keqpërdorur paranë publike.

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Me të vërtetë është për keqardhje se si në seancat e kaluar disa asmblesistë thonin që është punuar nga qeveria. Me të vërtetë është punuar por si është punuar ja ku i kam disa fakte për punën që është duke u ndërtuar kanalizimi në disa fshatra, ja fotot, shihni! Ata që po i kryejnë punët janë militantë të partisë saqë edhe po kërcenojnë. Kam një pyetje për drejtorin e Arsimit, por meqenëse ai nuk është këtu po i drejtohem Nënkyetarit. A ka limit kohor se kur do të përfundojnë punimet në shkollën fillore në fshatin Bardh? A jeni duke i inspektuar punët sepse punët janë duke u bërë shkel e shko?

Kastriot Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Çështja e Parkut të Mirushës Nënkyetar, nuk e di kush e menaxhon? Kush punon dhe çfarë bënë? Aty edhe rrethojat kanë nisur t’i prenë dhe gjendja është për mjerim.

Drejtoresha e Kulturës kërkonte një fond për mërgimtarët. Më e rrugës ka qenë për një mërgimtar të mbulohen gropat nëpër rrugë si ajo Malishevë-Kjeve që mos t’i prishin automjetet se sa të organizohet një koncert për ta.

Dje e kam thirrur atë të Drenocit për mbeturinat sepse nuk vinë t’i marrin. Nuk kam obligim sa i përketë faturave as një cent, por ka 2-3 javë që nuk kanë ardh t’i marrin e aty na rrin edhe qentë endacakë. Edhe atëherë kur vinë t’i marrin ma shumë derdhin e gjuajnë se sa e marrin.

Kanalizimi në fshatin Gurbardh aty te vrellat dhe është keq që ajo lagje nuk ka kanalizim dhe të gjithë ato ujëra derdhen në rrugë.

Po fillon viti shkollor, a e dini që në lagjën “Mirëdita” janë mbi 500 qenë endacakë. Nuk e di kush do ta marrë përgjegjësinë nëse një fëmijë e hjanë qentë?! A ka përgjegjësi Komuna, apo duhet individët të merren me ta, apo organizojmë ne si asambleistë dalim ne i gjumë me gurë mbase e kemi marrur votën e qytetarëve?!

Hajdin Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse është seanca e parë Arbëreshë të uroj postin e zv. Ministrës në MTI dhe të dëshiroj suksese!

Shumë shqetësime ishin për rrugën Kjeve-Malishevë, njëjtë është shqetësim edhe i joni. Ajo rrugë nuk është farë nën kompetencën e Kuvendit Komunal. E ka marrë përsipër Ministria e Infrastrukturës dhe besomni që çdo ditë jemi duke ju bërë presion në kuptimin pozitiv që ajo rrugë duhet të shtrohet sa më shpejt sepse gjendja është shumë e keqe.

Hashim, rruga ka për tu shtruar për pak ditë sepse procedurat e prokurimit janë të përfunduara. Ndoshta është njëra ndër rrugicat e vetme që ka mbetur pa u shtruar atje.

Ne jemi duke e zbatuar projektin e vitit 2017 dhe jam i bindur që edhe rruga në Lladroc është në procedurat e prokurimit publik. Ne jemi duke e bërë ingjizimin e terrenit për vijën e trashë të kanalizimit prej Lladrocit e teposhtë e që është diku 8.9km dhe shumë shpejtë do të nënshkruajmë një marrëveshje me Ministrinë përkatëse për realizimin e këtij projekti.

Minitranziti ishte shqetësim i të gjithëve dhe është punuar për të lehtësuar qarkullimin e komunikacionit, por besomni që akoma nuk ka pranim teknik të asaj rruge. Ka pasur probleme gjatë realizimit të projektit dhe do të shohim se si do të zgjidhet ai problem sepse ajo rrugë nuk është shtruar sipas standardeve që duhet.

Leonitë, shumë shpejt do të fillojnë me kanalizimet në Turjakë. Kontrata është nënshkruar dhe besoj që so të zgjidhet problemi i kanalizimit në fshatin tuaj.

Uji i pijës për Carrallukë është brengë edhe për ne, por ndonjëherë uji do të duhet të përdoret me mirëbesim, por gjithësesi do të interesohemi se ku është problemi.

Kryetari është jashtë vendi dhe po ju garantoj që Kryetari Ragip Begaj është duke i kryer detyrat konform përgjegjësisë dhe autorizimeve që i ka marrë nga qytetarët e Malishevës.

Alban nuk e di a kam me t'i hek dilemat apo kam me t'i shtuar te çështja e kandidaturës. Po unë do të jem kandidati për Kryetar nga rradhët e NISMA, Kryetari aktual është kandidat, krejt këta drejtorë janë kandidatë për kryetar por në fund ne një kemi për ta nominuar sepse ligji e kërkon ashtu, e ne gjithë të tjerët kemi për të punuar mbarë e mirë që NISMA me i fituar zgjedhjet sikur në mandatet e kaluara.

Shkolla në Bardh është njëra prej shkollave që është në përfundim e sipër e që e kishte afatin për 1 shtator. Jemi duke e përcjellë vazhdimisht po mbikqyrësi e ka për detyrë që me i zbatuar penalitetet ndaj gjithë operatorëve ekonomik që nuk i kryejnë projektet me kohë dhe si janë të parapara.

Kastriot, ne jemi duke u marrë me atë problematikë tek burimi i ujit. E di që ajo lagje është pa kanalizim, por është problem aty sepse duhet të gjendet metoda për shkak vështirësive dhe për shkak të gurëve të fortë që janë aty.

Me sa di unë Ekoregjioni ka vendim nga Asambleja për lokacion, por nuk e di nëse ka vendim për të bërë riciklimin e mbeturinave aty. Ne do të merremi shumë seriozisht me këtë punë sepse ankesat e qytetarëve janë në vijim e sipër.

Parku i Mirushës po mirëbahet deri diku, nuk jemi të kënaqur as ne dhe aty punon një punëtor i Ekoregjionit, jo i yni. Besomni që edhe ai park ka me marrur një pamje tjetër shumë shpejt.

Rrahim Morina: Pas debatit jashtë rendit të ditës kalojmë në debatin për rendin e ditës. Materialin e keni marrë me kohë. Po ju informoj që KPF-ja ka kërkuar që komisionet t'i shqyrtojnë raportet e drejtorive përkatëse. Të gjitha komitetet i kanë shqyrtuar ato raporte dhe i kam sjellur ato rekomandimet që kanë komitetet. Pra para vetës përveç raporteve i keni edhe rekomandimet. Gjithaashtu i keni edhe kërkesat që ju kanë drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë dhe asaj të Arsimit. Drejtoria e Arsimit është përgjigjur me një shkresë e që juve ju kam përcjellur me material, ndërsa Drejtoria e Bujqësisë nuk është përgjigjur fare. E hapi debatin për rendin e ditës.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Kërkoj që të hyjë në rendin e ditës Plani i Punës i Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Përsosmëri me Aftësi të Kufizuar.

Hashim Vrenezi: Sa i përketë rendit të ditës grupi ynë i PDK-së jemi që pika e 11 dhe 16 të hiqen nga rendi i ditës. Për pikën e 11-të nuk janë respektuar procedurat që kërkohen me udhëzimin administrativ nr. 15/2016 i cili rregullon këtë fushë. Në nenin 6, pika 1.3 nuk është respektuar fare që të jepet arsyeshmëria ekonomike si dhe interesi i përgjithshëm ekonomik për këtë inkubator. Ndoshta ju keni dashtë që shoqiata "Malasi" të jetë administratore e këtij inkubatori dhe përmes saj të bëni keqpërdorime të parasë publike.

Sa i përketë pikës së 16-të e cila kinëse është shqetësim i banorëve të fshatit Bubavec e sipas informatave që kemi siguruar ne nuk është problemi se është shqetësim i banorëve sepse ka banorë që nuk e dinë që ekziston kompani që nxjerr gur dekorues, e nuk është gurthyese e leje më që është pengesë për ta. Ne kemi konstatuar që pengesë aty është e disa kompanive tjera që

janë të paregjistruara si biznese që nuk kanë as pëlqim nga Kryetari për të nxjerr gur, e as licencë për t'i nxjerrë ata gur dekorues. Thjeshtë është një konflikt interesi i bizneseve. Prandaj ne kërkojmë që të hiçen nga rendi i ditës këto dy pika dhe të votohen në pako të dyja.

Arbëreshë Krasniqi: Përshëndetje për gjithë ju të pranishëm! Me vëmendje i dëgjova shqetësimet edhe para rendit të ditës e që janë të arsyeshme të shqyrtohen dhe të trajtohen, por të shihet veç zi për mua nuk është e pranueshme. Malisheva ka filluar të ndërtohet e të zhvillohet për së mbari.

Jam që rendi i ditës të shkoj kështu siç është, të votohet në tërësi e të diskutohet më tutje për pikat në veçanti.

Alban Krasniqi: Për pikën e 11-të mendoj që nuk janë ato arsyet e vetme që u përmendën sepse në KPF janë diskutuar edhe më shumë. Kryetari nuk na është përgjigjur dhe na ka rrejt secilin prej përfaqësuesve që kemi pasur takim me të ku ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i NISMA. Kryetari ka premtuar që për dy javë do t'na jep përgjigje mbi çështjet që ne ja kemi adresuar ndër to kërkesa për qasjen në dokumentet zyrtare, raportet e Drejtorisë së Bujqësisë që nuk na përgjigjet, qasja e komiteteve në vendimmarrje si vëzhgues, kërkesa për vendosjen e hapësisrës së Kryesuesit etj. ne nuk e kemi marrur asnjë përgjigje për të gjitha këto. Ne nuk mundemi të trajtojmë kërkesa të një Kryetari i cili është i shurdhur ndaj kërkesave tona e që janë legjitime. Atëherë pika e 11-të edhe për këto arsye edhe për ato që përmendi Hashimi duhet të hiqet nga rendi i ditës.

Pika e 16-të është e ngritur si çështje nga qytetarët e Bubavecit nëse pretendimet e parafolësit janë të qëndrueshme, le t'i ngrit kur vjen rradha e diskutimit të kësaj pike. E di që aty kanë nënshkruar qytetarët, Kryesia e fshatit dhe jam që kjo pikë të mbetet në rendin e ditës e të debatohet.

Valon Krasniqi: Ne grupi ynë kërkojmë që pika e 11-të të hiqet nga rendi i ditës dhe jemi që të futet në rend dite propozimi i Albanit për Komitetin e Shëndetësisë.

Sylë Dukolli: Po ndërlidhem me parafolësin se është e vërtetë që kemi mbajtur takmi me Kryetarin si përfaqësues të grupeve politike lidhur me disa çështje dhe Kryetari ka pasur për t'u përgjigjur por ishte koha e pushimeve e ndoshta e ka vonuar. Ndërsa fjala "po rren" është e rëndë shumë Alban, është i pari i Komunës e duhet ta kursesh. Ai për një periudhë 2 jave eventualisht 1 muaj do t'ju përgjigjem, e kam të shënuar.

Sa i përketë rendit të ditës unë jam që të votohet ky rend i ditës në tërësi dhe të mos largohet asnjë pikë.

Rrahim Morina: Propozimet i mora nga parafolësit dhe Hashim të dy pikat nuk mund të votohen në atë formë, pra në pako. Unë mund ta hedhi në votim së pari një propozim që a të votohen në pako, nëse kalon ajo tani e hedhi propozimin ashtu siç keni kërkuar ju, por jo të dy pikat të votohen menjëherë sepse ndokush do me votu njërin dhe tjetrën jo.

Kastriot Berisha: Kryesues propozimi i Hashimit ishte në emër të grupit duhet të hidhet në votim, në i marrtë votat mirë, nëse jo prapë mirë.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues, të lutem mos puno me dy standarde! Në seancat e kaluara kur të ka kovenuar ty i ke hedhur në pako, e kur s'po të kovenon jo, pavarësisht asaj që Hashimi kërkoj që të hiqet edhe pika e 11-të e që grupi ynë do të jetë kundër. Ka propozuar në pako, mos ja moho të drejtën!

Alban Krasniqi: Ju nuk po e kuptoni dallimin esencial. Propozimi i hashimit për pako hudhet si propozim kush është që këto dy pika të votohen në pako, e masandej hidhet në votim propozimi i Hashimit që të votohen në pako. Rregullorja e thotë kështu, nuk mundet kryesuesi me hudh në votim propozimin e Hashimit menjëherë pa votuar se kush që këto pika të votohen në pako.

Filloreta Bytyqi: Përshëndetje për gjithë ju të pranishëm! Kjo është një situatë e paqarët se çfarë procedura duhet të bëjmë në Kuvend. Kam disa legjislatura që jam këtu dhe na nuk kemi të drejtë të bëjme procedurë mbi procedurë. Ka propozim, ka votim dhe nuk mundemi ne të bëjmë procedurë.

Rrahim Morina: Ju lutem përgatiti për votim. Propozimi i Hashimit është që pika e 11-të dhe e 16-të të hiqen nga rendi i ditës dhe të votohen në pako. A jeni që të votohen këto dy pika në pako si propozim i PDK-së? Kush është për?

Për: 8

Kundër: 14

Abstenim: 0

Atëherë nuk kalon propozimi i PDK-së që pika e 11-të dhe 16-të të votohe në pako.

Alban Mazreku: Kryesues ne kërkojmë një pauzë prej 5 minutash sepse kemi një konsultim ne grupi ynë.

Rrahim Morina: Pas pauzës grupi i PDK-së e ka fjalën nëse ka diçka për të deklaruar.

Alban Mazreku: Meqenëse nuk kaloi propozimi ynë në pako atëherë shkojmë në votim për secilën pikë veç e veç.

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi ka propozuar që të hiqet nga rendi i ditës pika e 11-të gjithashtu edhe LDK dhe VV? Kush është për?

Për: 7

Kundër: 16

Abstenim: 0

Me këtë votim kjo pikë mbetet në rendin e ditës.

Propozimi tjetër i Hashimit ishte që të hiqet nga rendi i ditës pika e 16-të. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 8

Abstenim: 0

Me këtë votim kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.

Kemi një kërkesë nga Alban Mazreku si Kryesues i Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara. Fjala është për Planin e Punës të këtij komiteti e që materialin e sjellim ndërkohë. Kush është për që ky propozim të futet në rendin e ditës?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 0

Atëherë kush është për për rendin e ditës me pikën që u hoq dhe atë që u shtua?

Për: 20

Kundër: 1

Abstenim: 2

Atëherë kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e II dhe IV të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës. E hapi debatin. Atëherë mbase s'ka debat, kush është pro miratimit të procesverbaleve pa vërejtje?

Për: unanimisht

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/156 datë: 22.05.2018 të Kryesuesit të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural. Urdhëroni Kryesuesi i Komitetit e keni fjalën!

Kastriot Berisha: Nuk është e rrugës të debatojmë deri sa drejtori nuk është këtu. Drejtori i Bujqësisë jo vetëm këtë mandat por edhe në atë të kaluarin ka qenë njëri prej më injoratëve. Me atë injorancë ai e injoron vetëvetën.

Me datë 22.05.2018 në Komiteti për Bujqësi ju kemi drejtuar Kryetarit, Kryesuesit, dhe drejtorit të Bujqësisë me një kërkesë ku kemi kërkuar që ne si Komitet të jemi pjesë e Komisionit për Ndarjen e Subvencioneve për Makinat Mjellëse dhe Multikultivatorët, por ne s'kemi marrur asnjë përgjigje.

Ne në emër të Komitetit kërkojmë të nxjerrim një vendim që e obligon drejtorin e Bujqësisë që Komiteti të jetë pjesë e komisioneve për ndarjen e subvencioneve.

Alban Krasniqi: Kjo sjelleje e qeverisjes komunale është jokorrekte dhe jopolitike është sjelle makiaveliste dhe inatçore. Nëse është për inati qytetarët duhet juve PDK-së me ju pas, tani këtyre si degë e juaja që janë dal. Shaktarët e shaktërrimit të Malishevës fillimisht jeni ju, masandë njëjtë edhe këta kanë vazhdu.

Është hipokrizi tani me u marrë me një kërkesë që po do me i luftu keqpërdorimet në bujqësi e në anën tjetër po ju vazhdon keqpërdorimet tjetër mënyrë. Për vjen keq, por po e humbi edhe shijen e të bërjes opozitë, të bërjes politikë e të bërjes përfaqësim të qytetarëve. Por, megjithatë LVV ka ditur të ngritet çdo herë mbi këto inate dhe mendo që këto kërkesa që ka ngritur Kryesuesi i këtij Komiteti janë të drejta, sepse edhe ne para jush i kemi ngritur këto kërkesa. Nëse duhet të nxirret vendim prej Kuvendi, ai vendim duhet të nxjerret për të gjitha komitetet që të ketë vëzhgues në monitorimin e punës, pra drejtori duhet të ketë obligim që të ftoj komitetin ose komisioni për çështje të tilla, madje edhe në komisionet që i ngrit Kryetari për fusha të caktuara.

Kastriot Berisha: Alban, ke qenë pjesë e PDK-së edhe ti. Për ta prish shtetin, për të sulmuar organet shtetërore është VV. Shpesh po e përmend pas 4 vjete, jam i vetmi kandidat që vetëm dy ditë kam marrë pjesë në fushatë dhe kam qenë më i votuari. Kur të duash provohemi për vota edhe pa fushatë sepse janë qytetarët ata që votojnë.

Kryesues, ju dhe Albani pikën që e hoqëm e keni shti në KPF ashtu siç ju ka tek juve pa u votuar fare aty, pra pa rregulla.

Nuk është mirë që të njëjloset asnjë parti, asnjë individ pa pasur fakte. Pas 4 vjete përsëri jemi në garë dhe do të shohim a po i merr këto vota.

Alban Krasniqi: Unë kam qenë në UÇK, por mora vesh që kishe qenë edhe ti si 10 vjeç. Çudi?! Ti dhe disa të tjerë që këtë vend e keni pru në këtë gjendje me 60.000 veteranë. Kur të duash e deklarojmë pasurinë unë dhe ti sa kemi fitu. Por nuk po do të reflektosh edhe pse po thua jemi të ri, por s'po e merrë barrën dhe përgjegjësinë edhe të atyre më heret se çka kanë bërë. Për dy minuta të fundit këtu po i ndërron qëndrimet. Nuk po bëheni serioz! Në KPF tjetër gjë po flet, dërsa si po ndikohesh prej këtyre tjetër gjë flet. Unë nuk kam ardhur këtu me t'i përfaqësuar bizneset e tua dhe borxhin që ja keni biznismenëve të tjerë. Unë këtu e përfaqësoj LVV dhe konceptin e saj.

Kastriot Berisha: Nuk ke bagazh, jo ti, por shumë pak që të shtyhen me bagazhin tonë. E dinë të gjithë që kam qenë praktikant në spital ushtrak. Po ta vertetoj, prej 4 axhallarëve dhe 1 dëshmor që janë 5 e që kanë qenë në luftë, jemi të regjistruar vetëm një mixhë dhe 1 dëshmorë. Sa i përket pasurisë ne jemi 2 vëllzër dhe i kemi 96 punëtorë që punojmë në ndërtim.

Rrahim Morina: Ju lutem, nuk keni nevojë që të lëshohi në këto çështje! Është mirë të debatojmë për pikën e rendit të ditës. Po të përgjigjem Kastriotit që unë nuk jam vegël e askujt as sot e as dje.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues, rregullat nuk bëhen aty për aty dhe nuk mundesh të ma ndërpreh fjalën!

Unë nuk jam për punën, vizionin dhe platformën politike të PDK-së, por individët mbrenda saj e që janë njerëz me parime e që dalin këtu e i thojnë faktet i mbështes fuqishëm. Me pru pikë të rendit të ditës pa votuar nga KPF e që është duke funksionuar jashtëligjshëm kjo është shkelje e ligjit.

Alban, dil e thuaje publikisht që kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur me rregulla siç duhet dhe është votuar në KPF, të garantoj që të kisha besuar. Anëtari tjetër e tha që ka ardhur pa rregulla dhe neve po na shkaktoni hamendje sepse po vinë pikat ashtu si po ju teket anëtarëve të Kuvendit. Kjo është keqpërdorim e të vetmës mundësi që keni në KPF pa anëtarët e NISMA dhe mos nxënësi punë në Kuvend me çështje të cilat nuk i kalojnë procedurat ligjore! Personalisht dhe në emër të grupit ju kisha lutur mos keqpërdorni emra të dëshmorëve këtu! Individualisht mund të diskutojmë sa të doni, por jo me emra të dëshmorëve.

Hashim Vrenezi: Kjo është çështje që më prek direkt mua sepse jam anëtar i KPF-së. Është e vërtetë që çështja e Bubavecit është diskutuar heshturazi në mes teje Kryesues dhe Albanit dhe është futur në rendin e ditës pa e hedhur në votim kjo është edhe në procesverbal. Ju NISMA në KPF i keni vendet të rezervuar e pse nuk doni të merrni pjesë aty është çështje e juaja. Përgjegjës jemi na aty dhe e marrim përgjegjësinë e plot se çka ndodh aty. Çdo veprim kundërligjor jam kundër, çdo veprim i arsyeshëm jam pro atij.

Valon Krasniqi: Grupi ynë e përkrah propozimin e Kastriotit që të jetë një anëtar në vëzhgimin kur ndahen multikultivatorët dhe makinat mjelëse.

Rrahim Morina: Jo anëtari nga komiteti të jetë vetëm vëzhgues por t'i ketë të drejtat e barabarta ashtu si anëtarët e tjerë të komisionit ashtu siç ka pasur të drejtë në Komisionin për Ndarjen e Bursave.

Alban Krasniqi: Unë dy herë e kam ngritur çështjen në fjalë që prek qytetarët e Bubavecit dhe kam kërkuar që me marr konfirmimin që a është votuar edhe kjo. Ka pasur ngritje dore për të gjitha si pako, nëse këto pika janë valide është edhe kjo.

Mund ta imagjinoj se kur të hymë në Gurthyesin e Thaçit se çfarë reagimi nga ju kemi me pasur. Vallah ma du ta shoh një që me del përpara për gurthyes të Thaçit të shkeli si me traktor për një kauzë që është e shenjtë, që çan shtëpi të njerëzve, që rrezikon jetën e njerëzve, e leje për një gurthyes të vogël kaq të madhe me ba. Kjo është veç me pas mizën nën kapuç.

Komisioni që e ka Kryetari është komision që e ka ai dhe ai e themelon e që ë bënë gabim. Ka qenë Filloreta në një komision si anëtare e LDK-së e përfaqësuar formalisht dhe e di shkeljet që i ka bërë atëherë bashkë me ata të tjerët. Neve nuk na duhet që të hymë formalisht as i cilësdo parti, sepse nuk është e arsyshme sepse kjo nuk është as me rregullore. Pushteti është i ndarë qartë. Deputeti ka të drejtë të mbikëqyr secilën punë, aktivitet të një komisioni të caktuar që mundet me qenë qeveritar, pra me monitoru pa qenë anëtar i komisionit. Edhe ne e kemi këtë të drejtë pra me mbikëqyr, por jo pjesëmarrës.

Kastriot Berisha: Alban, ne kemi qenë kundër pikës së Bubavecit dhe jemi. Në momentin kur insiston për një gurthyes, ti po do me shti në grusht atë.

Sa i përketë pikës së rendit të ditës ne Komisioni për Bujqësi kërkojmë që të nxirret një vendim që të obligohet drejtori që të sillen të gjitha dokumentet të aplikuesëve, përfituesëve që të publikohen dhe të shohin qytetarët se çka bahet me subvencionet. Nëse ka me shtu diçka në vendim e shtojmë bashkarisht të gjithë ato që janë të arsyeshme.

Hajdin Berisha: Kastriot, sa i përketë Drejtorisë së Bujqësisë të gjitha subvencionet edhe në 4 vitet e kaluara, përgjigjen ta ka dhënë në kërkesë. Një përgjigje e ka kthyer drejtori sepse me ka informuar për këtë. Apsolutisht, drejtorja injorantë dhe arrogante mbrenda qeverisë nuk kemi pasur asnjëherë dhe as nuk kemi me leju me pasë. Cili do qoftë vendimi që del nga këtu ne kemi për t'u bazuar në ligj dhe e kemi për obligim t'ju lejojmë në qasjen për dokumente zyrtare.

Kastriot Berisha: Përgjigje nuk me ka ardhë. Nëse do të kishte ardhë nuk do ta qoja në gjykatë. Edhe në mandatin e kaluar nuk ju ka përgjigjur askujt ai drejtor. Ne i kemi bërë 4 kërkesë e që janë të protokoluara por asnjë përgjigje nuk kemi marrë. Përderisa nuk na është përgjigjur s'di si ta quaj ndryshe.

Rrahim Morina: U bë shumë pluhur rreth pikës së Bubavecit. Fatkeqsisht nuk ka ingjizime. Alban Krasniqi ka marrë fjalën dhe ka kërkuar që kjo pikë dhe ajo e Drejtorisë për Rini, Kulturë dhe Sport të hynë në rendin e ditës. Unë kam kërkuar që nëse ka mundësi këto pika pasi kanë qenë në KPF të përcillen direkt për Kuvend dhe kështu jemi marrur vesh edhe pse nuk janë votuar.

Kalojmë te propozimi i Kastriotit i cili kërkoi që Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të përfaqësohet në Komisionin për Ndarjen e Subvencioneve në cilësinë e monitoruesit dhe të vëzhguesit pasi që nuk paska të drejta të plota me anëtarët e tjerë.

Alban Krasniqi: Nëse doni të merrni vendim për këtë kërkesë është kry kjo punë sikurse unë që kam pasur për drejtorë të shkollave sepse është kry ndarja e subvencioneve. Propozoj që të marrim një pauzë 5 minutëshe që të konsultohemi për këtë.

Rrahim Morina: Atëherë shkojmë për pushimin e drekës e kthehemi në ora 13:30.

Pas pauzës së drekës vazhdojmë me pikën e rendit të ditës aty ku e lamë të konsultimet e shefave të grupeve. Gjtaë konsultimeve ishte edhe Kryetari i Komiteti për Bujqësi dhe erdhëm në një përfundim që të votohet vendimi: Obligohet Kryetari i Komunës, drejtoritë përkatëse që në gjitha komisionet dhe komitetet përkatëse të përfshihen në procesin e monitorimit përfaqësuesit e komiteteve dhe të paisen me materiale përkatëse. Atëherë kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovet propozimi i Kastrioti në bashkëpunim me grupet e tjera politike.

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale, për vitin 2017 (Janar-Dhjetor 2017). Raporton Nënkyetari në mungesë të Kryetarit.

Hajdin Berisha: E di që kjo pikë 2-3 herë është shty nga rendi i ditës për shkak të mungesës së Kryetarit por tani jemi këtu dhe në pika të shkurtëra po e paraqesë para jush.

Të gjitha projektet që kanë qenë të realizuar për vitin 2017 qëllimi kryesor ka qenë që të përmirësohet jeta e qytetarëve tanë si në ndërtimin e rrugëve, të kanalizimeve, në vazhdimin dhe ndërtimin e ujësjellësve, shkollave, investimet në bujqësi, shëndetësi etj.

Infrastruktura e përgjithëshme ka qenë sfera ku më së shumti ka pasur investime, pa i lënë anash edhe investimet në bujqësi etj.

Viti 2017 ka qenë viti ku është fituar bindshëm me Ethet Hemorragjike pas një punë të madhe që është bërë me 3-4 drejtori të qeverisjes lokale dhe ka qenë prioritet për ne. Këtu është arritur sukses i plotë edhe në nivelin e pickimeve edhe në nivelin e infeksioneve dhe po ashtu në numrin e rasteve me vdekjeve që për 4 vite rresht nuk kemi pasur asnjë rast.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë, kush e dëshiron fjalën?

Arbëreshë Krasniqi: Falemnderit Nënkyetar për raportin e punës 1 vjeçare! Kanë kaluar më shumë se 6 muaj që kjo pikë është dashtë që të diskutohet e që është shtyer për disa arsye që ndonjëherë kanë qenë se si Kuvend nuk e kemi pasur disponimin që të diskutojmë në mungesë të Kryetarit.

Ne jemi krenar për punën që është bërë për Ethet Hemorragjike. Ne kemi qenë të shqetësuar për këtë gjendje në Malishevë, megjithatë fal punës dhe angazhimit të kësaj qeverie në përgjithësi dhe Kryetarit Begaj ne kemi arritur që këtë gjendje ta ulim në 0. Uën i përgëzoj të gjithë ata që kanë kontribuar dhe ju lutem që të vazhdojnë me këtë ritëm që Malisheva të mos e këtë më këtë problematikë.

Janë shumë investime kapitale si në shkollat, rrugët, trotuaret, ujësjellës të cilat Malishevës po i japin një zhvillim pozitiv të funksionimit të mirëfilltë të punës dhe të lehtësimit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

I nderuari Nënkyetar, bëjë thirrje që edhe rrugët, ndërtimet e shkollave, e çdo investimi të monitorohen ashtu siç keni filluar ta bëni tani që mos të kemi vërjetje për punimet siç ka ndodhur në të kaluarën.

Alban Mazreku: Nënkryetari për këtë raport i ceki disa investime në infrastrukturë, kanalizim etj. Kam një pyetje. Çfarë investimesh janë bërë aty? Ne jemi duke e parë se çfarë punime janë duke u bërë.

Shumë herë është përmendur ndërtimi i shkollave e krejt fushatën e ka bërë në ndërtimin e 40 shkollave Kryetari, por shkolla e Bubavecit ka më shumë se 5 vite që nuk ka përfunduar. Në raportin e drejtorit të Arsimit e pashë që në këtë vit do të lëshohet, por për shkak të procedurave të prokurimit është shtyrë për 5 vite. Ne e dimë dhe këto gjëra nuk shtiten te ne.

Sa i përket investimeve në qytet u bënë 5 vjet që asnjë kocë nuk ka lëvizë në qytetin e Malishevës.

Është promovuar shumë shtrimi i minitransitit që Nënkryetari tha që nuk është pranuar akoma teknikisht, por ka ndonjë procedurë ose penalti që ju ka dhënë asaj firme nga qeveria komunale. Në raport e pashë rregullimi i ndriçimit publik, por unë dy apo tri herë e kam ngritur çështjen e ndriçimit publik e që janë nda diku 46,000€ për ndriçim, por ndriçimi publik nuk funksionon. I gjithë buxheti i Komunës së Malishevës për investime kapitale është i koncentruar maksimalisht në katër firma. Të gjitha ato i kanë fituar tenderat në ato shifrat e mëdha e që janë lobues të NISMA. Dilni dhe shihni punët në terren sidomos aty ku shtrohen kubëza. Nënkryetar nëse nuk e ka guximin Kryetari i Komunës t'i duhet me pasë me dal edhe me i stopu sepse kubëzat janë 4cm dhe bazament as 5 cm nuk po ju bëjnë.

Në këtë raport i kemi edhe raportet e drejtorive si Shëndetësisë, Administratës etj., në raportin e Shëndetësisë janë të specifikuar detajisht numri i pacienëve dhe i karahasuar me vitet paraprake psh: sa ka pasur në vitin 2016, sa në vitin 2017. Kërkoj nga drejtori i kësaj drejtorie se të gjithë pacientët që janë jo të Komunës së Malishevës edhe ata të regjistruhen që planifikimi i buxhetit për vitin 2019 të jetë edhe për këta pacientë të komunave tjera. Në laboratorin e analizave të shtëpisë së shëndetit ka shpesh mungesë të materialit, ka mungesë të materialeve të barnave parësore në shtëpinë e shëndetit.

Rrahim Morina: Sa i përket këtij raporti unë po ndalem tek Zyra Ligjore. Komuna e Malishevës nuk ka Zyre Ligjore, nuk figuron fare. Është Këshilltari i Kryetarit, Këshilltari Juridik, por Zyre Ligjore nuk ka. Unë kam kërkuar disa herë që të formohet një zyre e tillë. Për mua është e papranueshme sepse Auditori i Mbrendshëm e përfundon me 10 rreshta punën e vet pa asnjë detaj se ku e ka bërë auditimin.

Shqetësuese është se edhe Asambleja Komunale hynë në kuadër të Drejtorisë së Administratës, kjo është për t'u çuditur. Drejtori i Administratës raporton për Asamblenë, komitetet e të gjithë veprimtarinë e saj. Kjo nuk është çudi, sepse këta ashtu e shohin.

Sa i përket fushës së arsimit aty ka shumë ndërtesa dhe kushte të mira por tani duhet të punohet më shumë rreth ngritjes së cilësisë në arsim.

Shqetësuese për ne është edhe menaxhimi i projekteve që është shumë i dobët. Ku qëndron problemi dhe faji të gjithë po e dinë por nuk po reagojnë. Në realitet punohet dy-tri herë për një punë si te rasti i minitransitit që mbrenda 1 viti po intervenohet për gropa. Në menaxhimin e projekteve duhet të keni kujdes, sepse kush do që merr punë le ta kryej me nder.

Kastriot Berisha: Kryesues, nuk e di pse kërkon një menaxhim më të mirë të projekteve kur nuk janë në gjendje një realizim të mbledhjes ta relizojnë drejtpërsëdrejti?! Propozoj që për këtë pikë debatin mos ta zgjasim shumë dhe ne si grup e lëshojmë sallën nëse nuk ka transmetim direkt të mbledhjes.

Alban Krasniqi: Kur transmetimi i mbledhjes nuk bënë direkt mund të ingjizohet dhe më vonë të publikohet në ëeb-faqe. Por ëeb-faqja për video-ingjizime nuk bënë. Nëse një komunë në v.2018 nëse nuk ka aftësi teknike që të bëjë një ingjizim të një mbledhje është mirë që edhe puntorët që punojnë të rishikojnë pozicionin e vet, e duhet t'ju vije marre për këtë. Nënkrjetar është mirë që t'i merrni masat e duhura!

Në gjithë këtë raport vërejmë punë pa kritere, punë me cilësi të dobët, punë pa projekte të cilat në fund sjellin investime të dështuara me të cilat harxhohet paraja publike dhe pas pak kohe ato investime përsëri duhet të përsëriten në mas tjetër.

Nëse Komuna e Malishevës do të udhëhiqej me nder çështjen e minitrazitit është dashur ta dërgoj në gjykatë për shkak të punimeve me cilësi të dobët.

Idenë nuk e keni se çka jeni duke krijuar përmes investimeve në kanalizime. Jeni duke e krijuar një stërkeqe të dotjes mjedisore sepse nuk ka një masterplan. Duhet të bëhen kanalizime me standarde. Nuk bëhen kanalizimet diku 3 m e diku 7 m. Dikujt të shtëpia e dikujt i duhet 7 km me u lidh sepse nuk e ka librezën e partisë.

A e di ju që janë duke ndërtuar ujësjellëse nëpër fshatra, ama ujë s'ka?! E keni more projektin me Radoniçin që kushton 10,000,000€ e lidh dhe e bjen deri në Drenoc të Zatriqit e këndëj të vjen uji vet dhe e largojmë njëherë e mirë problemin e ujit sepse nuk zgjidhet me puseta. Nuk ka Malisheva resurse të ujit për ta furnizuar vetën.

Nuk na duhet as ato kubëza të shtrohen sepse janë investime të përkohëshme. Jeni duke bërë investime pa radhë. Nuk është shtruar kanalizimi e shtrohet asfalti. Kjo i bjen se heqet asfalti mbas një kohet për tu çelur kanali i kanalizimit. Këto janë paratë e tona, nuk duhet të keqinvestohen e keqpërdorën.

Investimet në bujqësi, a dini të më tregoni se cili është orientimi i Komunës për zhvillimin e bujqësisë? Që 3-4 vjet e tëra është sera, makina mjelëse, multikultivatorë dhe asnjë ide se çka kanë për të bërë. Besoj që këta nuk kanë as databazë, e dikush mund të merr dy herë psh: një makinë mjelëse. Ne kemi përfunduar në një katastrof me subvecionimin e bujqësisë sepse nuk ka plan.

Andaj Nënkrjetar, ndaleni investimet pa projekt, veç me paramasë dhe parallogari, investimet pa kriter sepse jeni duke e humb besimin edhe tek qytetarët. Ne u lodhem duke folur që sa kohë këtu dhe nuk po i merrni për bazë diskutimet tona, s'ka mbetur rrugë tjetër veç me ju drejtu gjykatës.

Hidajete Mazreku: Më vjen çudi sepse këtë raport shumë herë e kemi shtyrë në mungesë të Kryetarit, po ai është dashur së paku të gjej pak kohë vetëm te diskutimi i raportit sepse i e ka përgjegjësinë për këtë raport. Qytetarët e Malishevës përgjegjësinë nuk e lypin te drejtorët, por i adresohen Kryetarit.

Në këtë raport janë të përfshirë në tërësi prej auditorit e të gjithëve. Njësia e mbredshme e auditorit ka skaduar, është dashur të mbahen 10 takime e ai i ka mbajtur vetëm 5. Pse me dal Komuna e Malishevës keq?!

Sa i përketë raportit te Kuvendi ju i keni ngatërruar edhe komitetet. Aty thuhet që KPF-ja ka mbajtur 9-të mbledhje ndërsa Komuniteti për Komunitete 12 mbledhje kjo i mbjen që kanë mbajtur mbledhje më shumë se KPF-ja. Kur kam ardhur unë si Kryesuese e K. për Komunitet më kanë raportuar që kanë mbajtur vetëm 6 mbledhje ndërsa këtu shkruan që janë mbajtur 12.

Në këtë raport janë të përfshira të gjitha drejtoritë, por unë do të ndalem te ajo e Bujqësisë. Këtu shkruan që janë dhënë sera. Cila femër ka marrur serë? Këtu nuk është e specifikuar se meshkuj

e sa femra kanë përfituar sera. Në bazë të këtyre të dhënave unë asgjë nuk mund të flas. Duhet të ketë edhe këtu barazi gjinore, sepse mundemi edhe të hapim vende të reja të punës.

Kam një pyetje për Kryetarin, Shoqiata e Biznesit a është në kuadër të Kuvendit Komunal? A paguan Kuvendi Komunal para atyre dhe si është puna e tyre? Ndërtesa është ndërtuar atëherë e di që është ndërtuar për biznese. Ato janë duke punuar aty, por si e kanë statutin unë nuk e di?! Në bazë të auditimit Kryetari i ka ndarë 7,000€ pa lejen e Kuvendit për paga asaj shoqiate. Si janë dhënë këto para?

Sa i përket infrastrukturës rrugore, kanalizimve, ujësjellësve janë bërë shkele shko. Kam pasur projekt ideor prej kohës së Xhemali Bajrës në një bashkëpunim me Lipjanin që e tërë Malisheva me pas ujë. Për inate personale sot ne nuk kemi ujë dhe duhet të kërkojmë burime tjera.

Sa i përket ndriçimit publik, ne si lagje para qeverisjes së juaj e kemi pasur deri te xhamia. Ne kemi bërë kërkesa të vazhdueshme dhe kurrëfar ndriçimi nuk ka ardhur te ne në lagje.

Sylë Dukolli: Jam për të pasur një plan të punës e sidomos në sektorin e bujqësisë që investimet të shkojnë aty ku ka nevojë. Është mirë që të bëhet një analizë në bujqësi për profile të ndryshme se sa mund t'i ndihmojmë farmerët e komunës sonë. Ai që nuk e përdorë serën, multikultivatorin është mirë t'i kthehet Komunës që Komuna ta jep aty ku punohet me të.

Sa i përket infrastrukturës e sidomos te kanalizimet në fshatin tim ai është jo mirë i ndërtuar dhe ka shumë probleme sepse është ndërtuar para 10 viteve.

Te menaxhimi i projekteve është më rëndësi që përgjeshinë ta japin menaxhuesi i atij projekti duke përfshirë në fund edhe ata që e bëjnë pranimin teknik.

Sikur ky raport të ishte diskutuar në mars do të ishte më mirë sepse do të kishim kohë që të përmirësohemi për këtë vit. E falemnderoj Nënkryetarin i cili e mori përgjegjësinë komplet për raportin e Kryetarit, mirëpo Kryetari herave tjera është mirë që të raportojë për raportin e vet.

Hajdin Berisha: Nga të gjithë diskutuesit për Raporitn e Punës për vitin 2017 po mbizotëron kërkesa për përmirësimin dhe shtimin e cilësisë së projekteve që realizohen. Këtë edhe ne po e kërkojmë, s'ka dilemë për këtë. Ne kemi lëvizë përpara në këtë drejtim.

Në mandaitn e kaluar Komuna e Malishevës nuk ka pasur kompani projektuese, tani kemi një kompani projektuese të kontratueme dhe me këtë eliminohet mundësia e relizimit të projekteve të padetajizuara.

Në raport është e përfshirë puna e Kryetarit dhe e qeverisë në përbërje prej 11 drejtorive në mënyrë të përgjithësuar.

Arbresha e tha që për 4 vjet në mandatin e kaluar ka qenë prioritet Ethet Hemorragjike. Me të njëjtin elan ka vazhduar edhe sivjet. Besomni që ka qenë një luftë dhe një betejë e madhe për 4 vite rresht e po vazhdon edhe më tej në eliminimin e kësaj dukurie. Ky është viti i 5-të që nuk kemi asnjë rast vdekje dhe është si rezultat i punës jo vetëm i qeverisë komunale, por si rezultat i punës edhe të institucioneve tjera që kanë pasur përgjegjësi e që nuk kanë vepruar deri në vitin 2014.

Edhe pse ky raport po shtyrtohet me vonesë nuk zbehë asnjë centimetër rëndësinë e të gjitha projekteve që janë realizuar për vitin 2017 dhe punën e tërsishme të qeverisë lokale prej vitit 2014-2017.

Alban Krasniqi: Veç fjalë të ëmbla nuk na duhen, na duhen veprime konkrete. Nënkryetari nuk tregoj se a ke suspenduar ndonjë mbikqyrës të punimve deri tani? Asnjë! Nëse nuk është

suspenduar asnjë, kush e ka mbikëqyrur minitransitin? A ka përgjegjësi ai? A jeni bashkëpjesëmarrës në atë krim?

Ethet Hemorragjike janë rezultat i punëve i nivelit qendror, nivelit lokal dhe të gjitha institucioneve tjera, por megjithatë spërkatjet qindra e mijëra euro me airoplan nuk dihet se nga janë shkuar parat. Sivjet janë dy tendere edhe ai i nivelit qendror edhe ai i nivelit lokal që kanë qenë subjekt i ankesave të mëdha dhe i spekulimeve, madje edhe OSHP-ja e ka dhënë fjalën e vet. Sivjet jeni duke na rrezikuar Nënkrjetar sepse ka pasur pickime të rriqërave por fatmirësisht jo për shkak të ndërhyrjes së juaj por rriqërat nuk kanë qenë infektuese prandaj nuk kemi pasur raste fatale. Unë kam shpresuar që Drejtoria e Bujqësisë do t'i subvencionojë bujqit që të mbjellin tokën sepse ajo i parandalon rriqërat.

Është një projekt 400,000€ në emër të grumbullimit të mbeturinave për pastrimin e hapësirave publike e sot pas 1 viti nuk vërehet puna e këtij projekti. Ne për këtë është dashur të kemi një raport të veçantë sepse aty kanë qenë të punësuar disa njerëz dhe ka qenë kishe në emër të një bashkëpunimi. Ju nuk keni dhënë një raport për këtë.

Drejtoria e Inspektoritit thotë që janë 112 raste që janë marrë e që nuk janë shqyrtuar fare e sigurisht janë për ndërtime pa leje për të cilat asnjë masë nuk është ndërmarrë.

Hajdin Berisha: Për çështjen e Etheve Hemorragjike askush nuk tha që s'ka pasur pickime. Unë e ceka që i kemi ulur parametrat infeksioneve në 0 dhe ashtu i kemi ul në 0 nr. e viktimave. Askush nuk tha që i kemi zhdukur rriqërat prej Malisheve. Prandaj profesionist mjeksor janë të pranishëm në shkollë për të ligjëruar, për atë arsye janë mbajtur takime të rregullta me qytetarët në të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës për të sensibilizuar dhe vedijësuar qytetarët sepse është më shumë se çdo spërkatje edhe nga toka edhe nga ajri.

Rrahim Morina: Sipas Satutit të Komunës kërkohet që Raporti të votohet. Kush është pro aprovimit të Raportit Vjetor të Kryetarit të Komunës për Vitin 2017?

Për: 7

Kundër: 12

Abstenim: 0

Me këtë votim Raporti nuk aprovohet edhe pse nuk ka ndonjë efekt juridik.

Alban Mazreku: Kryesues, me një vendim të mëhershëm e keni përcaktuar që në ora 16 të përfundoj mbledhja. A mundemi ne që 2 kërkesat e qytetarëve dhe emërimi i anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore që të diskutohen sot, pastaj të caktohet një ditë tjetër për vazhdimin e mbledhjes? Fjala është për pikën e 7,8 dhe 9.

Rrahim Morina: Mirë, pas diskutimeve në mës vete, atëherë kush është për që mbledhja të vazhdojë të Martën në ora 10?

Për: unanimit

Me këtë votim atëherë mbledhja vazhdon të Martën në ora 10.

Alban Mazreku propozoi që sot të diskutohen pika e 7, 8 dhe 9. Kush është pro këtij propozimi?

Për: unanimit

Atëherë kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1231

datë: 23.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, sipas kërkesës nr.01/1116

datë:27.07.2018 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të z.Aziz

Januzaj nga fshati Senik KK.Malishevë. E hapi debatin.

Alban Krasniqi: Kryesues, kam dy çështje tjera. E para, kam një kërkesë që mos t'na bijnë më ujë të Serbisë. Sot flasim për krimet që ka bërë ajo këtu e me na pru ujë të Serbisë këtu është fyrrje për ne. E di që kjo është e paqëllimit, por më mos na silleni këtë ujë! E dyta, Nënkryetar, a ka mundësi që me qenë e gatshme klima sepse është e padurushme kjo temperaturë? Ky është një problem shumë i thjeshtë për t'u zgjidhur.

Rrahim Morina: Nëse nuk ka debat për këtë, atëherë e hedhi në votim. Kush është pro miratimit të kërkesës së z. Aziz Januzaj?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 0

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/253 datë: 03.07.2018 të parashtruar nga z. Sadik Bytyqi nga fshati Millanoviq, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. E hapi debatin për këtë pikë.

Mbase s'ka debat, atëherë kush është pro miratimit të kërkesës së z. Sadik Bytyqi?

Për: unanimitisht

Me këtë votim aprovohet edhe kjo kërkesë.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore. Për themelimin e këtij komiteti po ju lexoj vendimin. Përbërja do të jetë prej 7 anëtarëve. 2 anëtarë janë nga NISMA, 1 nga PDK-ja, 1 nga LDK-ja, 1 nga VV-ja, 1 nga shoqëria civile dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore. Shkojmë direkt me propozimet.

Alban Mazreku: Ne PDK-ja propozojmë Antigone Gashi-Zogaj anëtare për këtë Komitet.

Valon Krasniqi: Grupi ynë i LDK-së propozojmë Marigonë Morina.

Alban Krasniqi: Ne LVV kemi nominuar Agnesë Kastratin.

Filloretë Bytyqi: Ne do t'i sjellim emrat një ditë tjetër, sot nuk jemi të gatshëm.

Rrahim Morina: Mirë, mbetet NISMA me i sjell emrat një ditë tjetër. Ju tri grupet tjera a po pajtoheni që t'i hedhim emrat e propozuar në pako. Mirë atëherë shkojmë në votimin në pako. Kush është pro këtyre emrave të propozuar, nga PDK-ja Antigone Gashi-Zogaj, nga LDK-ja Marigonë Morina dhe nga VV-ja Agnesë Kastrati?

Për: 12

Kundër: 0

Abstenim: 8

Me këtë votim zgjedhën anëtarët e Komitetit për Barazi Gjinore. Atëherë ju falemnderoj për pjesëmarrje. Me këtë e shpalli të mbyllur pjesën e parë të mbledhjes. Shihemi të Martën në ora 10!

Pjesa e parë e mbledhjes përfundoj në ora 15:35.

Vazhdimi i dytë i mbledhjes së IX-të të rregulltë të Kuvendit të Komunë së Malishevës

Vazhdimi i mbledhjes mbahet me datë: 04.09.2018 dhe filloi në ora 10:15. Të pranishëm ishin në fillim të mbledhjes 20 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunal dhe media.

Rrahim Morina: Përshëndetje për ju të pranishëm! E hapi vazhdimin e mbledhjes së IX të rregulltë. Ne kemi shqyrtuar pikat e rendit të ditës 1, 2, 3, 7, 8 dhe 9. Ndërsa tani fillojmë me pikën e radhës e ajo është pika e 4-ërt e rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2018. Atëherë e lusim drejtorin që në pika të shkurtëra ta paraqesë Raportin.

Valon Mazreku: Përshëndetje për ju të pranishëm! Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Finacave Publike dhe Përgjegjësisë dhe Ligjit për ndryshime dhe plotësime të këtij ligji, gjegjësisht neneve 6.3, 6.4 dhe neni 45 për raportimet vjetore dhe periodike mbi menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit organizatat buxhetore janë të obliguara t'i paraqesin raportet periodike dhe përfundimtare finaciare. Prandaj, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka punuar Raporitn Fianciar për periudhën Janar-Qershor 2018 në bazë të standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe procedurave të thesarit mbi të hyrat dhe shpenzimet për këtë periudhë. Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse del se K. e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal Fiskal për vitin 2018 në shumë prej 14,103,724.06€ për të gjitha programet dhe nënprogramet. Kësaj i shtohet donacioni nga Qeveria Zvicrrane për Përformacë në vlerë 77,964€ dhe bartje e disa shumave të vogëla nga donacione të mbetura nga vitet e kaluara në shumë prej 1,123€ dhe finacimet nga huamarrja në vlerë prej 5,646€ del se shuma totale e buxhetit të regjistruar në sistemin informativ të Ministrisë së Finacave për K. e Malishevës në fund të qershorit të vitit fiskal 2018 kap vlerën prej 14,188,457.11€. Buxheti i alokuar për periudhën Janar-Qershor 2018 arrinë vlerën 8,924,320,21€ që d.m.th që shkalla e realizimit për shpenzim të buxhetit total është 62.90%.

Sipas synimeve nga librat e thesarit shkalla e shpenzimit të buxhetit të alokuar për periudhën Janar-Qershor arrinë vlerën 66.90%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë është 42.08%.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit realizimi dhe shpenzimi i tij sipas programeve, burimeve dhe kategorive ekonomike sipas mënyrës sintetike dhe analitike për periudhën 6-mujore.

Sipas buxhetit të Kuvendit Komunal për vitin fiskal 2018 nga të hyrat vetanake janë planifikuar të arketohen 818,797€. Plani i relaizimit i të hyrave vetanake për periudhën 6-mujore janë të hyra të rregullta që janë 305,938.62€. këto të hyra janë të futura në sistem dhe janë alokuar, kurse të hyrat të cilat arketohen nga gjobat e gjykatave për periudhën 6-mujore kapin shumën 7,430.00€, kurse gjobat në trafik arrinë shumën 38,960.00€ të cilat janë alokuar. Pra, të hyrat e përgjithëshme vetanake të realizuara në këtë periudhë janë: 352,320.62€. Sipas shënimeve

aktuale në këtë periudhë përqindja e realizimit i të hyrave vetanake në karahasim me palnifikimin është 42.8%.

Në vijim i keni të pasqyruara të gjitha të dhënat në tabela sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike si të hyrat ashtu edhe shpenzimet. Për çdo që keni të paqartë ose donjë vërejtje unë jam këtu dhe do t'ju përgjigjem.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Kush dëshiron fjalën?

Ali Morina: Përshendetje për të gjithë! Sa i përket Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve Janar-Qershor 2018, drejtor, çdo raport që sillet nga ana juaj vjen me të njëjtat vërejtje. Ne që nga fillimi kemi kërkuar që raporti të jetë më i specifikuar jo sikur në rastin konkret. P.sh: shërbime kontratuese tjera vlera është 147,000€, duam të dimë se çka përfshinë kjo shërbime kontraktuese tjera? Duhet të specifikohet për çdo gjë që është në raport.

Te raporti i shpenzimeve Kryetar, drekat zyrtare për periudhën Janar-Qershor kanë kushtuar 14,577€, ndërsa krahasuar me vitin e kaluar diferenca është mbi 10,000€.

Shpenzimet e udhetimeve mbrenda vendit i kemi të dyfishuara, prej 4,800€ i kemi në 8,574.00€. Gjithashtu edhe te shpenzimet e udhetimeve jashtë vendi po e njëjta gjendje është që d.m.th që keni shkuar me ngritjen 100% të shpenzimeve.

Te paisjet tjera vlera është 5,779.00€. Drejtor, çka janë këto paisje tjera? Duhet ta dimë me emër se ku janë shpenzuar dhe sa kanë qenë të nevojshme ato?

Sa i përket qeverisjes komunale me z. Begaj, vetëm për gjykatë keni paguar nga mallëra dhe shërbime 15,646.00€. Nga subvencionet i keni paguar 7,328.00€, nga investimet kapitale i keni paguar 49,475.00€ e që në total vetëm për gjykata keni paguar për këto 6 muaj 71,870.00€.

Kryetar, cilat janë masat që i keni ndërmarrë ju për këtë keqeverisje që po i kushton buxhetit komunal?

Rrahim Morina: Drejtor, në faqe 13, të hyrat vetanake Janar-Qershor 2018, nuk ekziston zëri buxhetor i të hyrave nga arsimi, pse? Ne dimë që ka të hyra nga arsimi. A është grumbulluar ndonjë centë nga hyrat nga arsimi?

Në faqe 17, shpenzimet për mallëra dhe shërbime p.sh: në vitin 2017 shpenzimet e telefonisë mobile kanë qenë 1,160.13€, ndërsa në vitin 2018 është 9,471.40€ kjo është një diferencë shumë e madhe.

Shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse në vitin 2017 kanë qenë 270€, ndërsa në vitin 2018 janë 13,615.00€. Kush është paguar nga ky zë buxhetor?

Shërbimet e përfaqësisë së avokaturës, janë 500€. Kush është paguar, cili avokat?

Shërbimet kontraktuese tjera, në vitin 2017 janë 81,085.00€, ndërsa në vitin 2018 është 147,558.97€ e që i bie dyfishi. Mendoj që këtu janë pagesat e atyre me kontratë në vepër dhe është rritur shifra. Cilat shërbime janë paguar nga kjo?

Te furnizimi me dru është një dallim i madh. Në vitin 2017 ka qenë 22,419.00€, ndërsa në vitin 2018 është 93,980.00€. Karburante për vetura në vitin 2017 janë shpenzuar 17,535.00€, ndërsa në këtë vit janë shpenzuar 28,770.00€ e shume raste të tjera.

Kur është bërë ndriçmimi publik në Astrazup ka ardhur deri tek lagjia ime dhe aty është ndalur sikur kur ta prenë. Ka pasur kërkesa nga qytetarët se pse ndodhi kjo dhe si ndodhi kjo. Kjo çështje është evituar, por nuk është mirë të ndodhin këto gjëra. Projekti nuk guxon të ndryshohet për inate dhe teke personale.

Alban Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Kur e kemi shfletuar planin e shpenzimit të buxhetit ky buxhet nuk përkon me atë plan për 6-mujorin e vitit 2018.

Për ndërtimin e shkollës fillore në Malsihevë kjo ka qenë e palnifikuar të filloj në muajin maj dhe shuma ka qenë e ndarë 1,700.00€. Ne me votën tonë këtu këtë shumë e kemi ndarë për pagat jubilarë për mësimdhënës dhe puntorë të komunës, por as kjo nuk ka ndodh. Kryetar, ku ka ngecur puna për pagat jubilarë?

Ndërtimi i minitransziteve në Malishevë që ka pasur të filloj në muajin Prill, por në këtë raport nuk ekziston as një e dhënë për asnjë investim në minitranszit.

Mirëmbajtja e palestrës sportive e palnifikuar në Maj e që janë të ndara 60,000€, e kam vizituar palestër dhe asnjë investim nuk është bërë aty dhe është në gjendje të mjerueshme.

Rregullimi i oborrit të Komunës, e planifikuar për mars, vlera e planifikuar 20,000€, por ky oborr nuk ka asnjë mirëmbajtje.

Gjërat që keni planifikuar nuk i keni realizuar, atëherë pse të kemi një plan të shpenzimeve të buxhetit deri sa nuk realizohet as për 5%?! A kemi nevojë për planin e shpenzimit të buxhetit, a jo?

Alban Krasniqi: Përshendetje për të gjithë! Në shumicën e kohës Kryetari ka munguar dhe shtrohet pyetja, kush e ka udhëhequr këtë buxhet? E ka udhëhequr një njeri me autorizimet e të cilit kanë vepruar drejtorët. Kryetar merri përgjegjësitë ashtu siç të takojnë dhe udhëheq me Komunën bile njëherë në jetën tënde. Fillo me këtë raport 6-mujor na informo me të gjitha kontratat dhe projektet që Komuna është duke realizuar në këtë vit dhe që janë në zbatim e sipër. Ne nuk i kemi informacionet që janë bazike.

Te pjesa e investimeve kapitale, e keni minitranszitin që kalon nga lagjia e "Veselajve". A e dini ju që ai projekt është një bashkëfinancim në mes nivelit lokal dhe atij qendror? A e din Kryetari që në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës, ne është dashur të debatojmë për trasenë e rrugës, praj kalimit të pronës në arë të kalohet në rrugë, sepse është projekt i Komunës. Ne jemi tërësisht të painformuar se si janë marrë vendimet, si është bërë traseja, nëpër çfarë pronash kalon etj.

Në fillim duhet të kemi listën e projekteve, pastaj të diskutojmë për raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për këtë 6-mujor, është e pamundur të debatojmë në këtë rast.

Realizimi i të hyrave vetanake që janë rreth 43%, është një dukuri që të hyrat qëllimisht për këtë vit janë ulur që artificialisht të konsiderohet se kinëse ka rritje të inkasimeve të të hyrave dhe përqindja të rritet. Te këto të hyra e kemi edhe një problem sepse nuk e kemi informacionin elementar për të trajtuar këtë çështje. Ai informacion është se kur të hynë të hyrat ato duhet të kategorizohen përveç sipas njësisive edhe një kategorizim tjetër se sa janë të hyra prej borxheve paraprake. Raporti fare nuk e ka këtë të dhënë.

Në projektet që po realizohen janë të përfshira vetëm disa fshatra. Fatkeqsisht ende një pjesë e fshatrave dhe e lagjeve padrejtësisht injorohen për motive partiake dhe politike. Fshatin Carrallukë qëllimisht në kohën e Isniut e patën lënë pa ujë. Çka është më e keqja ende ata qytetarë paguajnë shpenzime që s'kanë barë për ujë. S'ka pas ujë e janë detyruar të paguajnë faturat për ujë. Këto ditë për javë kemi pasur mungesë të ujit në fshatin Carrallukë. Nëse vazhdohet me këtë logjikë se ku janë votat shkojnë investimet do të përfundoni shumë keq. Kjo logjikë e veprimit është komplet titiste. Kur të doni e bëjmë krahasimin e fshatit Banjë me Carrallukë, e shihni se si është vepruar. Unë jam kundër logjikës përçarëse që ju po e bëni. Kjo duhet të merrë fund.

Arbëreshë Krasniqi: Si Raport i të hyrave praktike ka qenë me raportu drejtori i fushës së caktuar dhe këtë model e ka e gjithë Kosova. Valonin e falemnderoj për këtë raport dhe është në anën tonë që të japim edhe sugjerime dhe vërejtjet tona. Sigurisht që në raport kemi edhe disa paqartësi të ngritja dhe ulja e shpenzimeve, të lutem na u përgjigj.

Për projektet e mëdha kapitale vendim përfundimisht e ka marrë Asamblea, dhe këtu i kemi orjentuar se ku do të shkojnë. Ne mund të flasim vetëm atëherë kur kemi fakte për një projekt, nëse nuk ka shkuar aty ku ne e kemi orientuar. Në Gullboc me 70 vota që i ka NISMA ka shkuar shkolla që e ka vlerën mbi 100,000€. Pra, Nisma nuk e ka logjikën e ndarjes së projekteve në bazë të votave. Nisma ka marrë vota nga të gjitha fshatrat e K. së Malishevës dhe gjithë qytetarët i sheh të barabartë. Nëse titizmi ka filluar diku, ka filluar me heret dhe jo me qeverisjen tonë. Është mirë të mos merremi me paragjykime.

Sylë Dukolli: Ne jemi duke e shqyrtuar një raport, jo duke e rishikuar për të bërë një planifikim të ri të buxhetit. Shumë nga parafolësit e mi më shumë kanë diskutuar për politikë se sa për raportin.

Më mirë do të ishte sikur të dhënat të ishin më të detajuara e t'u referoshim nga zërat buxhetor. Buxheti është një kërkesë dhe krejt shpenzimet janë një faturë. Por edhe në kërkesë, edhe në faturë duhet të ketë sqarime.

Ne këtu nuk i kemi projektet dhe përqindjet e operatorëve të cilët i kanë kryer punët. Në bazë të kryerjes së punëve të këtyre operatorëve faktikisht e shohim edhe shumën e këtyre investimeve kapitale që bëhen në rrugë, ndërtesa, shkolla etj. P.sh: Shkolla e fshatit Bubavec nuk ka përfunduar ende sikur të ishte raporti i 2016-tës mund të ndodh që operatori i ka marrë të gjitha mjetet. D.m.th projekt mbas projekti dhe shpenzim mbas shpenzimi vimë deri në përfundim. Për t'u marrë në përgjithësi nuk është e kaluar norma e 6-mujorit të shpenzimeve sipas planifikimit që kanë bërë në këtë buxhet në vitin 2017.

Hidajete Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Raporti i të hyrave 6-mujor 2018 ka shumë gjëra të përgjysmuara, nuk ka të theksuara të gjitha nëpër zëra buxhetor. Te mallëra dhe shpenzime, tek Zyra e Kryetarit është shpenzuar një shifër e madhe diku 15,000€, ndërsa në vitin 2017 është 6,000€.

Te raporti i Kryetarit kam theksuar se ka qenë shumë i ngarkuar me tërë qeverinë prej 11 drejtorive, për këtë nuk ka pasë nevojë. E nevojshme do të ishte vetëm menaxhimi i Kryetarit se ku ka ndikuar ai në përmirësime, e jo pasqyrën konkrete të të gjitha digastereve ose drejtorive. Herave tjera raporti i Kryetarit le të vije se çka ti ke bërë si menaxhues i Komunës, ku ka ndryshuar nëpër këto digastere.

Valon, pse janë këto shpenzime të mëdha? Ju duhet t'na tregoni kushtet, rrethanat që kanë ndikuar në rritjen e 100% të shpenzimeve si të mallëra dhe shërbime.

Tek shpenzimet kapitale, projektet në bazë të periudhës nuk kam pa që është duke u punuar askun përveç në shtrimin e kubëzave. Tani nuk mund të flas për këto shpenzime sepse nuk e kam të specifikuar në raport. Ku kanë shkuar këto shpenzime?

Nga mallëra dhe shërbime janë shpenzuar për këtë 6-mujor 1,400€ për komunitetet. Cilat projekte janë realizuar me këto para? Nuk është shumë e madhe, por mbase jam Kryesuese e Komitetit për Komunitete dëshirojë të di.

Sa i përketë Zyrës për Barazi Gjinore, aty jemi në rregull. Ne kemi palnin e detajuar janë të ndarë 2,800€ për vitin 2018 dhe ne i kemi shpenzuar 1,099€. Këto janë të specifikuar si shuma por jo ku është investuar.

Të gjithë parafolësit që ë ngritën çështjen për shpenzimet për gjykata, ju lutem mos lejoni që për gjykata të shkojnë shumë para. Ne, njerëz mund të baktrojmë si Kuvend nëse avoktet që i keni nuk e kryejnë punën si duhet. Ata duhet që të punojnë më shumë në mbrojtjen e parashë publike sepse kësaj Komune i takoj edhe unë.

Valon Mazreku: Për të gjitha vërejtjet dhe shqezësimet e juaja, do të mundohem sadopak që t'ju jap përgjigje. Për secilin zë buxhetor që është i pasqyruar në tabela, janë të pasqyruara vetëm në mënyrë sintetike. P.sh: shërbime kontraktuese tjera, unë nuk mund të di saktë cilat shërbime tjera pagu.

Te drekat zyrtare dhe krahasimet në mes të këtij viti dhe atij të kaluar, ju sqaroj që në vitin e kaluar është aplikuar kodi 5-shifror në të cilin kanë qenë të detajuara dhe të specifikuara shumë kode ekonomike të cilat nuk kanë mundur me pasqyruar një gjendje reale saktë. Psh. ka pas kod regjistrimi i makinave dhe ka pas kod sigurimi i makinave. Pra krahasueshmëria nuk është bazë e fortë se a janë rritur shpenzimet këtë vit në raport me vitin paraprak për shkak të kodit 5-shifror. Ali, shpenzimet e udhëtimeve mbrenda dhe jashtë vendit, ne në librat e thesarit e kemi raportin për secilin zë buxhetor analitik, ku tregon se çka saktësisht është paguar. Te shpenzimet brenda vendi nuk janë të gjitha të Komunës, p.sh: mund të jetë një eskursion i një shkolle për një aktivitet të fituar që ne e kemi finacuar. Pra edhe këto shpenzime janë futur brenda kësaj kategorie.

Vendimet e gjykatave kanë ndodhur fatkeqësisht dhe Ministria e Finacave i ka paguar ku ka dashur ajo vet. Ka marrë edhe nga mallëra dhe shërbime, investimeve kapitale, subevcioneve ku ka pa që ka mjete.

Te paisje tjera, mundemi me pa në mënyrë analitike se çka saktësisht janë shpenzuar, çka kemi blerë me paisje tjera, por nuk mundemi ta pasqyrojmë në raport finaciar.

Kryesues, participimi nga çerdhja e fëmijëve janë 11,341.05€, edhe çerdhja është në kuadër të arsimit. Nuk e di pse the që nuk ka të hyra nga arsimit.

Shpenzime të telefonit, përfshihen telefonja mobile dhe ajo fikse. Këtu ka pasur mundësi që janë paguar edhe faturat e vitit 2017 të cialt nuk kanë pasur mundësi të paguhen në atë vit. Secila organizatë buxhetore ka obligime që i mbesin në fund të vitit. Diku kështu mujor vëtmë për telefonin mobile është rreth 1,000€, ndërsa ai fiks është më lirë.

Furnizimi me dru, 153,000.00€ ka qenë kontrata e viti të kaluar dhe fatrat që kanë mbetë të paguara në vitin 2017 ne i kemi paguar në këtë vit si dhe furnizimin e sivjetëshëm në disa raste. Derivatatet për veturë 28,770.71€, këtu hynë zjarrfikësit, shëndetësia, komuna e që janë mbi 30 atutomjete të cilat furnizohen.

Te mirëmbajtja e ndërtesave, janë shpenzuar 18,032.38€. kjo shifër është varësisht nga niveli i mirëmbajtjes. Kontrata është ende e hapur, nuk ka përfunduar. Këtu janë pasqyruar vetëm ato që janë paguar.

Shpenzimet komunale, 305,000.00€ dhe vetëm me mbeturinat në bazë të kësteve mujore janë diku rreth 200,000€. Këtu hyjnë rryma, uji, etj.

Pagesat për familjet e dëshmorëve, vendimi është nxjerrë nga Kuvendi në vitin 2017 dhe ka qenë valid deri më 31.12.2017. Prej 1 janarit ata kanë filluar të paguhen nga Ministria, ne deri në atë kohë i kemi pagaur nga 437.50€ për një familje. Në pamundësi që pagesat të realizohet në vitin 2017 ne e kemi realizuar këtë vit.

Në bazë të buxhetit të miratuar të vitit 2017, Alban Mazreku, Zyra e Prokurimit e kanë marrë buxhetin dhe e kanë bërë planinin dinamik të prokurimit, kjo shkon sipas procedurave të prokurimit. Psh: nëse është një projekt kapital, ato kategorizohen në bazë të vlerës, nr. të ditëve

të hapjes, procedurat e ankesave e kjo ka mundësi që të shkoj deri në 2 muaj me procedura. Pra kjo nuk ka mundur të hyjë mbrenda 6-mujorit si shpenzim. Ata kanë planifikuar që shkollën e Malishevës në maj të fillojnë procedurat e prokurimit.

Pagesat përcjellëse, Asambleja ka marrur një vendim që këto pagesa të bëhen sipas kontratës kolektive dhe të shkojnë përmes projektit të shkollës fillore "Ibrahim Mazreku" që ka qenë në projekt-buxhet. Mirëpo, Ministria e Finacave e ka kthyer dhe nuk ka lejuar këtë. E kam shkresën nga kjo ministri. Tani jemi duke e pritur një takim me ministrin që të diskutojmë për këtë çështje. Ndërtimi i minitranziteve ende nuk ka filluar për shkak të çështjes së pronave.

Alban Krasniqi, në bazë të gjitha atyre që ke folur te krahasimi i të hyrave vetanake në mes të viteve 2017 dhe vitit 2018. Ne shpesh herë po flasim për centralizmin e vendimmarrjes që ka Ministria e Finacave në raport me planifikimin e komunave ose të gjitha organizatave buxhetore që bëjnë për buxhetet e viteve vijuese. Edhe te të hyrat vetanake është Ministria ajo që e përcakton të ardhmën, ose përcakton vlerën se sa ke me realizu të hyra vetanake mbrenda 1 viti. Në vitin 2017 përafërsisht ka qenë 1,097,000.00€ ndërsa ata e kanë zbritur në 819,000.000€ sa është aktual.

Profesoreshë, te Zyra për Komunitete mund të nxjerrim në mënyrë analitike se çka është shpenzuar atë që ju po kërkon.

Sylë, ende nuk është bërë pranimi teknik i shkollës në Bubavec dhe nuk janë kryer komplet pagesat për këtë shkollë.

Rrahim Morina: Drejtori ka njohuri për të gjitha këto, por edhe nëse nuk ka njohuri më vjen shumë keq që gjendet në atë pozicion. Ai duhet të dijë të gjitha në hollësi. Te zëri buxhetor i të hyrave në arsim gjithëmonë ka pasur të hyra. Këtu fare nuk figuron. Arimi fillor, i mesëm dhe ai mesëm i lartë çdo dokument që lëshon merr para. Shakollat fillore, të mesme të ulëta marrin nga 1€ për çdo dokument që lëshojnë. Ashtu edhe në shkollën e mesme të lartë kur dokumentet shpallen të pavleshme merren para.

Ju asambleistë i keni nga 2 minuta për të replikuar drejtorin aty ku keni bërë pyetje dhe nuk keni marr sqarime.

Alban Krasniqi: Ne kërkuam listën e projekteve dhe nivelin e zbatimit të tyre. Të dhënat se cila kompani e ka marrë projektin, sa zgjatë ky projekt, sa është realizuar deri me tani, këto na duhen. Na duhet lista e pagesave në emër të vendimeve gjyqsore. Sa vendime gjyqsore janë paguar nga xhepi yn, për secilin rast veç e veç. Ne vjet i kemi 92,000.00€ që janë harxhuar në emër të këtyre vendimeve, afërsisht 60% nga kjo shumë kanë qenë për sektorin e arsimit. Vetëm në 6-mujorin e parë sivjet janë 70,000.00€. Ky është dëmtim i qëllimshëm i buxhetit. Dikush duhet të marrë përgjegjësinë.

Pranimi teknik i objekteve dhe i investimeve të tjera infrastrukture që janë me dhjetëra objekte në komunën tonë që s'kanë pranim teknik. Nëse ndonjëherë ndodh ndonjë rast ose zjarr besomni që keni përgjegjësi penale e ligjore, por keni edhe përgjegjësi te familjet t tyre. Minitranzitin, sallën e sporteve etj i keni pa pranim teknik.

Pse shkolla në Bubavec nuk po funksionon është sepse dikush i ka marrë 20%, s'ka tjetër logjikë kjo heshtje e juaja. Këto padrejtësi duhet të ndalën! Pse nuk po i merr Kryetar masat sepse e keqja ka triumfuar edhe mbi ty fatkeqësisht.

Kastriot Berisha: Drejtori tha që janë furinizuar me mbi 3,000m dru. Drejtor, po del 135,000.00€ po del shuma për 3,000m dru, nëse i ke marrë me 45€ metrën. D.m.th 41,000.00€ po i mbetesh borgj ai që e ka fitu tenderin.

Filloreta Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë! Çdo herë ka vend për vërejtje, por nuk d.m.th që nuk është punuar. Nëse vetëm një shkollë nuk është funksionale në Malishevë nuk d.m.th që shkollat tjera nuk janë funksionale.

Drejtor, e di që në raport nuk detajohen gjërat sepse kam kërkuar edhe unë më heret dhe Veseli më jepte një raport tjetër shtesë. Andaj po kërkoj që Albanit apo kujdo qoftë tjetër jepnia në mënyrë të detajuar të gjitha ato që po kërkojnë.

Te të hyrat në arsim, besoj që drejtori i Arsimit do t'jep një përgjigjie adeukte, por nuk ka numër të madh të të hyrave në arsim sepse Qendera e Kompetences dhe shkolla e Kjevës më nuk janë në menaxhimin e komunës, të vetmet të hyra janë nga 2.50€ për duplikat në gjimnaz dhe nga 1€ për dëftesa.

Nëse dikush po mendon që është shumë ekspert dhe i zoti le të shkoj të punonojë në NASA sepse ne nuk jemi për të punuar pak më larg.

Hashim Vrenezi: Kam një pyetje për Kryetarin meqenëse drejtori nuk mundi të përgjigjet. A është dashur të ketë të hyra nga Inspektoriati? Nëse nuk ka të hyra nga Inspektoriati konsideroj që në Malishevë nuk paska asnjë parregullësi dhe gjithëçka qenka në rregull.

Të hyra është dashur të ketë edhe nga Agjensia e Pyejeve sepse është e pakuptimtë në qoftë se kalojnë 2 vite dhe nuk ka asnjë të hyrë.

Valonit arsyeja pse ja kanë zvogëluar të hyrat nga qendra është për shkak të mungesës së të hyrave dhe s'ka mund të tregoj performancë në të hyrat e vitit paraprak që ta kanë caktuar prapun.

Programi për investime publike është dashur të jetë i publikuar në veb-faqen e komunës sikurse e kanë edhe komunat tjera. Je i obliguar që ta publikosh. Kem argumente që ka devijuar buxheti nga ai që është i miratuar.

Kryetari-Ragip Begaj: Përshëndetje për të gjithë! I gjithë debati që u bë këtu i kontribon punës sonë dhe na ndihmon që të përmirësohemi në të ardhmen. Natyrisht që mund të ketë gabime ku do që punohet.

Unë asnjëherë nuk kam munguar nga Malisheva, nuk e di pse ju ka shqetësuar kjo gjë. I kam pasur 2-3 udhëtime jashtë vendi dhe Nënkryetari më ka përfaqësuar mua dhe i ka pasur të gjitha kompetencat e duhura. Pa dijenin time Nënkryetari nuk merr asnjë vendim, vendimet i marrë të gjitha unë. Të gjitha ato qoftë mirë apo keq më takojnë mua, unë ballafaqohem me ato dhe jap përgjegjësi para jush.

Formulari i raportimit i të hyrave dhe shpenzimeve është i përgjithësuar, nëse diçka detajisht ju intereson drejtori e ka patjetër që të jep sqarim për çdo shpenzim.

Të gjitha kontratat janë publike në veb-faqen e komunës, sepse është e pamundur që të gjithë materialin me sjellë para jush. Çka do që ju interson për këto kontrata unë ju jap përgjigjie.

Ka shpenzime të gjykateve, ka procese para 5-6 vjetësh sepse gjykatat po vonohen. Ka procese edhe tonat dhe unë nuk e kam besimin shumë tek gjykatat. Ka raste të ndryshme dhe konsideroj që na kanë dënuar padrejtësisht.

Alban, të gjitha shkollat kanë pranim teknik, a është i mirë ai pranim a jo, unë nuk e di?! Edhe në Bubavec nuk kam me lëshuar shkollën pa u finalizuar. Po ju jap një të dhënë tjetër. Mos mendoni

që kam dëshirë të dëmtohet buxheti i Komunës së Malishevës dhe po mundohem që ta ruaj. Këtë vit kam qenë pak më dorëlibër.

Te shpenzimet mbrenda vendi, kemi shpënzime për nxënës, për HENDIKOS dhe disa shpenzime që janë krijuar aty për aty. Besomeni që janë shpenzime të nevojshme. Asnjë nuk janë shpenzime të mija.

Shpenzimi i buxhetit për këtë 6-mujor deri diku ka shkuar mirë, nuk ka projekte politike dhe jemi munduar që të përfshihen të gjitha fshatrat. Nuk e di kemi mundur t'ju përgjigjur ashtu siç keni kërkuar por, drejtori është i obliguar që t'ju jep të gjitha sqarimet e nevojshme.

Hashim, për të hyrat nga Inspektoriati nuk ka të dhëna që ka, por do të intersohem dhe kam vërejtje për inspektorët. E di që kanë aplikuar gjoba por ato shkojnë për gjykatë, ama për situatën tjetër nuk e di.

Agjensia e Pyejeve; kemi angazhuar disa të punësuar për ruajtjen e pyejeve dhe mendoj që nuk janë dëmtuar më.

Ju informoj që të shtunën fillon projekti për tranzitin e madh të Malishevës në ora 12. Vjen ministri i M. së Infrastrukturës dhe është projekt i Ministrisë.

Rrahim Morina: Shkojmë për pauzën e drekës, kthehemi në ora 13:30 për vazhdimin e seancës. Pas pauzës së drekës me rradhë e kemi pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi i mundësisë për caktimin e hapësirave për zyrën e kryesuesit të Kuvendit dhe të grupeve politike në Kuvendin e Komunës së Malishevës. Meqenëse Kryetari nuk është këtu, tha që vonohet për gjysmë ore a kalojmë në pikën, as pikën e Auditorit të mbrenshëm pa Kryetarin nuk mund ta diskutojmë dhe as pikat e tjera që kanë të bëjnë me të.

Drejtori i D. për Bujqësi nuk është këtu që të raportojmë atëherë deri sa të kthehen ata kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor Janar-Qershor 2018 të punës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Urdhëro drejtor e keni fjalën.

Liridon Hoti: Përshëndetje për të gjithë! Në cilësinë e drejtorit të Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale po ju paraqesë raportin 6-mujor Janar-Qershor. Kjo drejtori detyrat dhe obligimet e veta i ka kryer komform Ligjit për Shëndetësi dhe Udhëzimit Administrativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Kjo drejtori i ka kryer punët e veta sipas kësaj skeme organizative: drejtori, shefi i drejtorisë, zyrtari për sigurimin e punëtorëve në botën e jashtme, zyrtari për përkujdesjen e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, zyrtari për sigurimeve pensionale dhe invalide, zyrtari për shëndetësinë primare publike dhe mentale, drejtori i Qendrës për Punë Sociale dhe drejtori i QKMF-së. Materialin ju kemi sjellë me kohë dhe për të gjitha vërjetjet, pyetjet dhe sygjerimet që keni mund t'i ardesoni. Falemnderit!

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Raporti në parim është gogja i mangët. Unë jam Kryesues i Komitetit për Shëndetësi. Ne me dt. 29.08.2018 e kemi shqyrtuar raportin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe pjesëmarrës në mbledhje ka qenë anëtarët nga VV dhe LDK. Ky Raport më shumë është narrativ se sa i krahasueshëm me vitet paraprake. Këtu pasqyrohet vetëm skema organizative, mirëpo në të nuk kemi asnjë krahasim as me vitin 2017.

Drejtor, për 6-mujorin e dytë të vitit 2018 të merren shifrat dhe të bëhet krahasimi me vitin 2017.

Ne i kemi nxjerrë disa rekomandime ku një kopje e ka edhe drejtori dhe po i lexoj para jush. Në mbledhjen e I-rë të jashtëzakonshme të Komitetit për Shëndetësi u diskutua plani i Komitetit si dhe Raporti 6-mujor i Drejtorisë së Shëndetësisë. Sipas anëtarëve të Komitetit ky raport është i mangët dhe duhet të plotësohet sipas rekomandimeve të anëtarëve të Komitetit.

1. Të kërkohet Plan i Punës i Drejtorisë së Shëndetësisë për 6-mujorin e dytë të vitit 2018 si dhe plani i HANDIKOS-it
2. Të raportohet numri i të punësuarëve në QKMF në Malishevë si dhe numri i të punësuarëve tjerë në Qendrat e Mjekësisë Familjare nëpër fshatra
3. Të raportohet dhe të bëhet krahasimi i familjeve të ndihmuara nga Qendra për Punë Sociale në vitin 2017
4. Të bëhet krahasimi dhe participimi i të hyrave për 6-mujorin e parë të vitit 2027 me 6-mujorin e parë të këtij viti, ndërsa
5. Për vitin 2019 të rritet buxheti për shëndetësinë pasi në Shtëpinë e Shëndetit në Malishevë e gravitojnë edhe fshatrat jashtë komunës sonë
6. Të sillet një raport nga Qendra e Mjekësisë familjare për pacientët jashtë Komunës së Malishevës të cilët kryejnë shërbime këtu
7. Kudo që punësohen njëzë është mirë që ata të jenë profesional sepse te Zyra për Pensione të Jstëme, përsori që është aty ndoshta nuk e di asnjë gjuhë të huaj e realisht dokumentet duhet të plotësohen në gjuhë të huaja.

Arbëreshë Krasniqi: Mungesa e Kryetari nuk e di sa e arsyeton pikën e 11-të, megjithatë ne e presim dhe e diskutojmë.

Do të ishte mirë që drejtori ta paraqiste raportin në pika të shkurtëra para nesh jo vetëm në formën e shkruar, por, megjithatë ne e kemi pasur materialin me kohë dhe kemi pas mundësi që ta lexojmë dhe ta analizojmë.

Kjo drejtori ndër vite mbanë shumë përgjegjësi, punë të ndjeshme dhe pjesa ndërmese e këtyre punëve ka rezultuar suksesshëm edhe në mandatin e kaluar dhe po vazhdon edhe tani.

Rastet të cilat trajtohen jashtë komunës sonë, është e rëndësishme që saktë të evidentohen si raste që trajtohen në QKMF. Rastet të cilat janë të liruara nga shërbimet të jenë të saktësuar.

Unë e përgëzoj stafin e QKMF-së për punën e palodhshme që e bëjnë dhe kërkoj përgjegjësi sepse kemi vërjetje drejtor që ka mungesa të stafit profesionist në Qendren e Mjekësisë Familjare në Malishevë.

E kam thënë dhe përsëri e them që parandalimi i Etheve Hemorragjike na bënë krenar për tjetimin e sinqertë dhe punën e palodhshme në këtë drejtim.

Për personat me regjim shtrati dhe ata me dializë është obligim i yni që ne t'ju ofrojmë kushte dhe përkujdesje më të mirë dhe të trajtohen me seriozitet.

Alban Krasniqi: Qëllimi i raportimit i cilës do fushë është për të bërë një lloj vlerësimi krahasuar me objektivat, planifikimin se çka është arritur dhe çka jo, dhe pse nuk është arritur. Këtu shihet që mungon ky element e që është bazë.

Në hyrje thuhet që: “puna kryhet komform objektivave të caktuara nga Kryetari i Komunës si dhe në harmoni me Planin vjetor të komunës”. Në këtë raport përmendet palni vjetor i punës, por cili është ai plan? Cilat janë objektivat? Çka është arritur dhe çka jo? Mbase nuk janë këto elemente bazë, a mund t'i themi raport?! Atëherë drejtor dil këtu e tregona këto së pari, pastaj të lëshohemi në çështje konkrete.

Përmendet në raport kontrata e HANDIKOS-it, ne nuk kemi këtë kontratë dhe nuk e dimë se çka përmbanë ajo, çfarë lloj shërbimesh kryhen, kush i kryen ato, si është përzgjedhur stafi që i kryen këto shërbime, a i plotëson kushtet ai staf, a ka licencë ai staf, ku janë kryer ato shërbime, sa ka kushtuar kjo kontratë, sa paguhen ata punëtorë etj?

Qendra e Emergjences pak para zgedhjeve ka filluar të punohet dhe nuk e di se çka ka ndodhur prej atij momenti? Ku kemi arritur si Komunë për sa i përket krijimit të ambientit të Qendrës së Emergjencës prej shërbimeve tjera që i kryen Qendra e Mjeksisë Familjare? Ku jemi në këtë drejtim? A është i parashikuar projekti në buxhetin e këtij viti të ndërtimit të qendrës së re? Aty janë do themele dhe e di që janë nda 90,000.00€ në emër të një vendimi gjyësor. Te ekipi mobil i profesionistëve shëndetësor nuk kemi listë. Është e nevojshme që të kemi këtë listë.

Masat për luftimin dhe parandalimin e Etheve Hemorragjike është një raport i shkruar, por nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim. Cilat kanë qenë punët që kanë kryer niveli qëndror? Cilat janë punët që i ka kryer niveli lokal? Kush e ka bërë spërkatjen? Diku e kanë bërë spërkatjen në një lagje dhe shkruan se është spërkatur tërsisht fshati.

Niveli i kulaitetit të shërbimeve shëndetësore në QKMF është tejmas jashtë dhe larg pritshmërive të nevojave reale që i kanë qytetarët. Të dhënat këtu tregojnë që ne kemi numër të madh të pacientëve që kërkojnë ndihmë në QKMF. Në anën tjetër kemi një numër të madh të ankesave të qytetarëve për kualitetin dhe sjelljen e personelit si dhe mungesën e barnave. Shqetësues është numri i madh i pacientëve që i drejtohen Gjinekologjisë, e dyfish më i madh ky numër është në sektroin privat. Kjo i bjen drejtor që e ke për detyrë me i bërë analizë këtyre shërbimeve edhe në QKMF edhe në sektorin privat dhe me ardh në përfundim se nga duhet të orientojmë ne parandë publike në përmirësimin e shëndetësisë.

Ne kemi nevojë për mamografi, në raportin e vitit të kaluar shkruan që përkohësisht është vendosur mamografia. Mamografia është e rëndësishme sepse e zbulon kacerin në fazat e hershme dhe mund të shpëtojë edhe jetë në këtë rast.

Kërkoj që drejtori të më përgjigjet për gjerat që kërkoja dhe t'i merr për bazë rekomandimet që ja dhashë si anëtar i Asamblesë.

Sadije Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, kam një pyetje për ju. Pasi që shëndeti i qytetarëve është parësor më interson të di lidhur me shërbimet shëndetësore sidomos nëpër fshatra. A plotësohen nevojat e qytetarëve tanë për shërbime shëndetësore kur e kemi parasysh mungesën e mjekëve, apo mosfukcionimin e ambulancave në tërësi e sidomos kjo gjendje është shqetësuese nëpër disa fshatra?

Hidajete Mazreku: Drejtori duhet të tregojë se si menxhohet Shtëpia e Shëndetit. Edhe ajo se çka fole drejtor por edhe këto shënime që i kemi marrë me material ajnë gjysmëake. Ne e dimë se në çfarë gjendje është QKMF-ja.

Drejtor, duhet të tregosh për stafin aty, si keni menaxhuar orarin e tyre, si funksionojnë drejtorët e reparteve duke u nisur nga zyret poshtë deri te gjinekologjia atje lart? Si punojnë mjekët, a kemi ne staf të mjaftueshëm në QKMF për t'na ofruar shërbime që ne të mos shkojmë në Prishtinë. Unë tri vjet rresht për tenision jam shkuar në Prishtinë. Pse të shkojmë në Prishtinë kur ne kemi internistin, kardiologun dhe kemi mjetet edhe pse janë të vjetra për të kryer shërbime? Drejtor, raporti është dashur të jetë më i specifikuar. Kam një pyetje për pacientët që janë me regjim shtrati e që shumicën e ka HANDIKOS-i. Çfarë marrëveshje keni me HANDIKOS-in?

Më shumë shërbime si te dentisti, ashtu edhe te gjinokologu kryhen në privat se sa në QKMF. Gjinokolgët më shumë punojnë nëpër zyre private të vetat se sa aty. As një lindje e parë nuk bëhet në Malishevë pati po jo komplikime. Asnjë grua nuk e ka librezën që kryen kontrollë në gjinekologji në Malishevë. Aty këtu nëse bëhet ndonjë kontrollë. Pothuajse të gjitha këto shërbime kryhen nëpër ordinaca private.

Kryetar, më vjen mirë që u ofrohen shërbime të mira atyre që janë në dializë.

Ka njerëz që janë me diabet dhe marrin insulinë. Shëtpia e shëndetit ato duhet me i dhanë falas, por pacientët i blejnë ato në barnatore kur nuk ka insulina.

Në maj kam dëgjuar përmes mjeteve të informimit që kanë qenë 238 pickime nga rriqërat. Ku janë ato spërkatje? Ku janë ato mjete që kanë bashkëpunuar niveli lokal dhe ai qendror?

Higjena kudo është në nivelin e ultë. Edhe këtë po ju them drejtor.

Sylë Dukolli: Vërtetë Drejtoria e Shëndetësisë është më e rëndësishmja dhe që ka të bëjë me të gjithë qytetarët sepse të gjithë kemi nevojë që t'ju drejtohem mjekëve.

Duke ju referuar shërbimeve shëndetësore që marrin pacientët e komunave tjera siç janë ata të Klinës në Kjeve i ka rehatuar ato 12-13 fshatra për rreth. Unë kërkoj që edhe në ditët ku pazohet të futet mjeku kujdestar sepse aty i marrim shërbimet primare.

Unë dhe të gjithë qytetarët kërkojmë shërbim më të mirë edhe në QKMF e të mos presim në rradh sepse dihet që kemi mjekë dhe mund të kryejnë shërbime në nivelin e duhur.

Për shërbimin ambulator kanë bërë shumë sepse edhe vet jam njëra ndër familjet që e ka marrur këtë shërbim dhe na është ofruar ndihma kur është dashur.

Sa i përket Etheve Hemorragjike është në purkujdesje të plotë Drejtoria e Shëndetësisë dhe ka bërë spërkatje dhe duhet të bëhet një analizë që numri i pikckimeve të bie. Është fat që s'kemi më vdekje si më parë dhe është një vetëdijësim i qytetarëve sepse po mbahen ligjërata nëpër shkolla dhe vetëdijësimi bënë punë më shumë se sa ofrimi i shërbimit direkt.

Ilaz Krasniqi: Përhëndetje për të gjithë! Kam një pyetje për drejtorin rreth pediatriisë. A ka kuadro të mjaftueshëm që Pediatria të punojë me dy ndërrime pasi që numri i pacientëve është shumë i madh? Vizitat e fëmijëve më shumë kryhen në sektorin privat se sa në sektorin publik.

Hashim Vrenezi: Rastet e rënda që intervenohet me qepje. A bëhet qepja në QKMF? A bënë ta dimë se pse nuk bëhet? Të njëjtit mjekë që punojnë në QKMF qepjen e bëjnë në sektorin privat. Në një rast familjar jam detyruar që pacientin ta dërgoj në Gjakovë për një qepje për shkak që nuk është intervenuar në QKMF.

Nyjet sanitare në QKMF janë në gjendje të tmerrshme, dyert e toaleteve nuk mbyllen, toaletet janë tërësisht jofunksionale dhe kundërmojnë. Një erë e tmerrshme ka qenë edhe në laborator që ka shpërthyer një gyp, nuke di a është rregulluar ai problem.

Shqetësim është edhe organizimi i pagesave që kryhen aty psh: personat që janë mbi 65 vjeç nuk duhet me pagu dhe e kërkojnë një pagesë me 0 duhet 65 vjeçarit të ngjitet në katin e dytë për një pagesë me 0. Nuk e di pse duhet me ja bërë atë maltretim pacientit poshtë e lartë? Kjo thjeshtë do një intervenim që të mos aplikohet në këtë formë.

Arbëreshë Krasniqi: Unë kam një vajzë dhe kam lind në QKUK, në Repartin e Gjinekologjisë. Jam tmerru dhe traumatizu me gjendjen dhe trajtimin në QKUK. Para një jave kam qenë në Emergjencë dhe kjo punë e të enurit nuk është shpikur në Malsihevë. Përveç që u endem herë një një repart e herë në tjetrin edhe ai shtrati ishte jo në gjendje të mirë dhe u dashtte që dy-tre vetë

ta mbajnë. Pra, shëndetësia keq nuk është në Malishevë, shëndetësia keq është në nivel vendi dhe ky është shqetësim për të gjithë.

Para juve diskutova dhe isha shumë kritike për këtë raport dhe Drejtorinë e Shëndetësië dhe nuk u kurseva hiç.

Rrahim Morina: Është një çështje që nuk u diskutua ajo është e maternitetit, mendoj që duhet të bëhet funksionale 24 orë. Nuk ofron kushte që të bëhet aty asnjë lindje. Kryetari duhet urgjentisht që të hartojë një plan që ky repart të funksionalizohet dhe lindjet të bëhen këtu.

Liridon Hoti: Kritkat, sygjerimet dhe vërejtjet e juaja besoj që do më shërbejnë për të ardhmen. Por, mos e shihni krejt zi. Po pajtohem që kemi gabime. Kemi gabime këtu në Asamble që po thirrëmi në shumë tituj, po thirrëmi në shumë heroizma dhe po thirrëmi shumë të dishëm se sa jemi.

Po, edhe drejtorja jonë i ka pasur objektivat, njëra ndër to ka qenë që QKMF-ja të mos jetë në gjendjen të cilën është sot. A është realizuar ajo, jo nuk është realizuar! A janë rregulluar ato toalete të cilat nuk dua t'i i shoh asht, jo nuk janë rregulluar! Pajtohem edhe unë më ju, por mos harroni ne jemi duke funksionuar me një buxhet i cili është bërë vitin e kaluar e që nuk të jep mundësinë për të përmirësuar gjendjen.

HANDIKOS e bënë një shërbim të mirë të cilin pa të nuk mundem më ta shoh shëndetësinë në Malishevë. I kryen disa vizita shtëpiake për punën e tyre duhet të lavdrohem këtu.

Dezinfektimi me prioritet nëpër fshatra është bërë aty ku ka pasur raste të pickimit më shumë. Merrni statistikën dhe shikoni dhe i shihni sipas rasteve.

Sa herë që keni ndonjë pyetje apo çështje që ju brengos për shëndetësinë qoftë edhe privatisht derën e keni hapur dhe unë jam i gatshëm të bashkëpunojë me ju.

Arbëreshë, po, ke të drejtë. As unë nuk jam i kënaqur me mjekë, por mos harro që 10 mjekë na kanë shkuar në specializim në Prishtinë. Kush do t'i mbulojë ata mjekë të përgjithshëm? Ne duhet t'i shohim të gjitha anët të cilat duhet me u pa.

Sadije, është dashur të tërhiqet mjekja nga Drenoci, nga Bellanica në mungesë të mjekëve në QKMF. Njëra ndër objektivat tona në fillim ka qenë që të funksionalizohen Qenderat e Mjekësisë Familjare nëpër fshatra.

Rastete me dializë i transportojmë në mënyrën më të mirë të mundëshme deri te spitalet. Ndërsa pjesa tjetër e pritjes dhe kryrjes së shërbimeve është e spitalit.

Profesoreshtë ju folët në mënyrë të përgjithëshme, një pyetje konkrete ishte për insulinat.

Insulinat kanë qenë mungesë në tërë Kosovën, ka qenë edhe në media.

Hashim, fatkeqsisht te ne nuk bëhen disa qepje të cialt janë më të rënda sepse nuk jemi të licencuar për këtë.

Baci Ilaz, kemi mungesë të pediatërve në QKMF për ta bërë në dy orare.

Syla kërkoj që të shtunën dhe të dielën që në Kjeve të ketë mjek kujdestar. Po ne në fillim e kemi pasur këtë si objektivë, por në mungesë të mjekëve nuk kemi mundur që ta realizojmë. Në QKMF i kemi dy vende të lira, por nuk kemi mjekë për t'i plotësuar ato vende.

Ndoshat dikujt i kam mbetur borgj në përgjigje, sido që të jetë mund t'ju përgjigjem edhe me shkrim për çfarëdo pyetje që keni.

Alban Krasniqi: Drejtorit ja bëra më shumë 4-5 pyetje esenciale, asnjë përgjigje nuk e mora. E përmendi HADIKOS-in por nuk m'i dha të dhënat që kërkoja. E përmenda Emergjencën, nuk

më dha përgjigjie. Na doli në pah një problem shumë i madh, mugesë e 10 mjekëve, por që nuk është reflektuar në raport. Drejtor bëhu i përgjegjshëm dhe mos na vë në lajthitje!
Nëse në raportin e auditorit thuhet që janë 46 persona me kontratë mbi veprën për shërbime profesionale, pra këtu e keni mundësinë për të gjetur e punësuar mjekë.

Rrahim Morina: Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i ka sjellur rekomandimet dhe ju para vetës i keni, ju lutem kush është pro këtyre rekomandimeve?

Për: unaimisht (20)

Atëherë mbase është Kryetari këtu i kthehemi pikave sipas rënditjes. Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i mundësisë për caktimin e hapësirave për zyrën e kryesuesit të Kuvendit dhe të grupeve politike në Kuvendin e Komunës së Malishevës.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, unë ju kam drejtuar Kryetarit me një kërkesë. Zyra e Kryesuesit të Kuvendit është shumë e vogël diku 3 me 2 dhe aty punojmë katër persona që i kryejnë punët e Kuvendit.

Kam biseduar me Kryetarin, i kam propozuar alternativa për Zyre të Kryesuesit e që është e domosdoshme. Nuk po kërkojmë komoditet por hapësirë për një punë normale të Kuvendit. Aty përgatien procesverbalet, mbahen komitetet, komisionet etj. Kryetari është zotuar disa herë por deri me tani nuk është kryer kjo çështje. Përveç kësaj kërkesa është edhe për zyre të grupeve politike që janë në Kuvend.

Ndër alternativat që kemi biseduar me Kryetarin është kjo. Zyra e Thesarit dhe paradhoma janë të përshtatshme për Kryesuesin e Kuvendit. Ne e kemi kërkuar këtë. Urdhëro Kryetar e keni fjalën, para se të hapi debat!

Alban Krasniqi: Kryetar, vetëm në hapësirën tëndë janë tri zyra. Byfeja e Komunës është 5 herë më e madhe se sa Zyra e Kryesuesit. Ka praktira shumëfish më të mira në Komunat tjera, por s'ka më të keqe se kjo. Nuk ka në asnjë Komunë që Zyra e Kryesuesit është 2 me 3. Ka komuna që edhe grupeve politike ju kanë ndarë hapësira pa pagesë.

Ne sot kërkojmë dhe duhet të votojmë e para, Kryesuesit t'i caktohet me vendim të Kuvendit Komunal që brenda kësaj ndërtese t'i ndahet Kryesuesit hapësira atë që e ceki Kryesuesi në një afat prej 30 ditësh.

E dyta, subjekteve politike ju bjen që të takohen me shuëm qytetarë atëherë duhet të jetë hapësira e përcaktuar për grupet politike. Aktualisht ka shumë ndërtesa në komunën tonë e që janë të pashfrytëzuara. Njëra ndër to është Muzeu, aty ka hapësirë ku është ashensori diku janë 6 zyre të lira. Me mirëputimin tuja për t'ja lehtësuar punën vetës dhe Kuvendit, dhe për të qenë një adresë ku qytetarët mund të të trokasnin na duhen këto zyre.

Valon Krasniqi: Edhe grupi ynë e sheh të arsyeshme që të krijohen kushte për Kryesuesin e Kuvendit, përcaktimi i hapësirës. Nëse nuk ka disponim Kryetari dhe ekzekutivi, atëherë këtu të votohet dhe të merret një vendim për këtë çështje.

Alban Mazreku: Edhe ne pajtohemi që Zyra e Kryesuesit të jetë më e madhe, jo vetëm për këtë rast që Kryesuesi është Rrahimi, por edhe për çdo kryesues tjetër që do të vie më pas pa asnjë anim politik. Në të njëjtën kohë e mbështesë edhe kërkesën që edhe grupet politike t'i kenë zyrat e veta.

Arbëreshë Krasniqi: Në këtë sallë kushtet janë të papërshtashme sepe dimrit është shumë ftohtë, ndërsa verës bënë shumë vapë. Është krejt e natyrëshme sikur të kërkonim fillimisht për krijuar kushte më të mira, në këtë sallë.

Para kësaj pike diskutoam për shëndetësinë dhe gjentjen që është atje, kërkuam që të përmirësohen kushtet në ofrimin e shërbimeve, duke e parë atë gjendje atje, në anën tjetër ju po kërkon një lluks. Sikur gjërat tjetër të ishin në rregull, sigurisht vota ime do të ishte për për këtë që po kërkon.

Pak rëndësi ka se prej cilës parti është kryesuesi. Ne e kemi pas kryesuesin nga NISMA, por nuk e kemi pasur një iniciativë të tillë sepse e kemi parë që ka raste më të rëndësishme se kjo.

Personalisht çështja e takmimeve me qytetarët është më e arsyeshme, sa i përket punës së Kryesuesit, aktiviteteve të tij përveç që do të votojë kundër më duket si kërkesë e turpshme.

Secili prej e nesh e dimë se sa angazhim dhe punë bënë kryesuesi. Me gjithë respektin për ty Kryesues, po flas si punë dhe aktivitet për secilin kryesues. Nuk është problemi se nëse i krijojmë një zyre më të madhe dhe më të mirë ka me ba punë dhe aktivitete më të shumta dhe më të mira, s'ka çka për të punuar më shumë.

Takimet e KPF-së janë mbajtur në anën e djathtë në hyrje të Zyrës së Kryetarit të Komunës. Asnjëherë nuk kemi pasur pengesë.

Kastriot Berisha: Është e vërtetë se këtu është vapë, sepse ne e kemi ngritur shumë herë këtë çështje dhe nuk ka pasur gatishmëri për të përmirësuar këto kushte. Është hera e 10-të sot të ingjizimi po ndërprehet dhe nuk është në gjendje që të nderqet.

Sikur edhe 10 ndërtesa komunale të ndërtoheshin, praktikë e secilit pushtet, duan sa më shumë zyre me pasë. Ka nga ju NISMA që i kanë nga tri zyre, pse Kryesuesi mos me pas një zyre më të madhe?

Ne kur dalim në konsultime rrimë në korridor për të diskutur dhe nuk kemi kushte të punës, prandaj zgjatin mbledhjet aq shumë sepse s'kemi ku për t'u konsultuar. Duhet t'i kemi secili zyret tona për të diskutuar kur kemi ndonjë çështje.

Arbëreshë Krasniqi: Nuk po më pegon Kryesues që të kesh një zyre më të madhe, por a më siguron ti që këtu do të biesh vendime të ligjshme? A më siguron që KPF-në ka me punuar karshi Statutit të Komunës dhe Rregullorës së Punës?

Ne si grup jemi kundër kësaj pike të rendit të ditës.

Hidajete Mazreku: Shumë zhurmë u bë në lidhje me hapësirën për Kuvendin Komunal të Malishevës. Kryetar, a ka hapësirë që t'i dedikohet Kryesuesit sepse është hapësirë e vogël? Aty ndonjëherë e mbaj edhe mbledhjen e K. për Komunitet dhet që punëtohet aty ta lirojnë vendin për 5 anëtarët. Në këtë rast ato i pengojmë në punë. Kërkoj që të zgjidhet kjo çështje sepse s'ka të bëjë asgjë me komoditetin. Çfarë pune mund të kryejnë aty 4 persona në një zyre aq të vogël, vlerësojeni vet?! Për çdo mbledhje të komitetit unë i drejtohem asaj zyre edhe pse hapësira për veprim është e vogël. Për këtë arsyeje mos çoni pluhur më shumë por të gjejmë një zgjidhje të kësaj çështje pavarësisht vendit ku caktohet.

Halil Morina: Përhëndetje për të gjithë! Sa i përket kësaj çështje po pajtohem që Kryesuesi e ka një hapësirë të ngushtë dhe është vështirë të punohet në atë zyre. Por jo vetëm Kryesuesi, por shumica e zyrtarëve komunal ndoshta nuk i kanë kushtet e favorshme për të punuar.

Mendoj që kësaj çështje po i jepet kahje politike, pushteti i NISMA nuk po do të lëshoj një zyre më të madhe sepse kryesuesi është i LDK-së. Mirëpo, edhe në mandatin e kaluar kryesuesi ka qenë i NISMA dhe ka punuar në këto kushte.

Çështja tjetër që më pengoi është logjika e bërjes së gjërave me dhunë. “Unë hi diku me zor. Jo ti nuk guxon me hi”. Më të vertetë kjo nuk më pëlqeu. Kjo punë duhet të zgjidhet duke u përpjekur sipas mundësive dhe në qoftë se ka hapësirë le të bëhet, në qoftë se jo, atëherë nuk ka! Kërkoj që kjo çështje të mos shihet si politike jo vetëm Kryesuesin, por secilin zyrtar këtu ka dëshirë ta shoh në kushte dinjitoze duke punuar.

Alban Krasniqi: Ndonjëherë po iket prej temës për të cilën jemi duke diskutuar. Kjo nuk është aspak politike. Këtu është pushtet dhe opozitë. Ne shohim rolin e Kuvendit më të rëndësishëm se sa e shihni ju. Ju nga këndvështrimi i juaj, ne nga këndvështrimi ynë. Megjithatë, nëse e shikojmë si hirarki institucionale as që është dashur të diskutohet puna e Zyrës së Kryesuesit sepse është dashur të jetë si duhet. Këdo që e kisha parë aty edhe në një pozitë më të ulër, për mua nuk është e dinjitetshme. Nuk po kërkohet lluks, nuk po kërkohet shpenzim, po kërkohet hapësirë për kushte normale të punës.

Luan Kryeziu: Duke ju referuar kërkesës pak e rëndësishme kishte me qenë Zyra e Kryesuesit karshi shumicës së Asamblesë. Ma mirë kishte me qenë të kishte zyre për grupet politike këtu ne në bazë të numrit të grupit mund të përcaktojmë edhe numrin e zyreve. Nuk është e nevojshme që Kryesuesi të presë 20 palë, ata vijnë me rradhë.

Kastriot Berisha: Mendoj që duhet të nxjerret një vendim sipas hirarkisë sepse hirarkia niset prej Kryetarit, Kryesuesit, Nënkryetari, drejtorëve e kështu me rradhë. Nuk e di çka ka të keqe këtu, pa marrë parasysh se kush është në atë pozitë?!

Kryetari-Ragip Begaj: Ne me Kryesuesin nuk kemi asnjë inat në mes vete dhe pajtohem me atë se çdo kush i ka mendimet e veta. Ndoshta është e mete e jemja që nuk jetoj në lluks por në kushte mesatare. Ndoshta dikush tani ka ardhur në pushtet dhe do më shumë lluks dhe kërkon kushte ma të mira, normale është edhe ajo. E di se Zyra e Kryesuesit është shumë e vogël, por 4-5 kryesues përfshirë edhe mua e kanë kaluar aty mandatin e tyre. Nuk është se nuk po dua unë, por ashtu ka qenë edhe më parë.

Zyret e ekonomisë që po i kërkon Rrahimi nuk bënë të lëvizën sepse ata kanë një punë të përbashkët dhe duhet të jenë afër njëri-tjetrit. KPF-ja gjithëmonë e kanë mbajtur mbledhjen te zyra te unë.

Ne kemi pasur drejtori edhe jashtë objektit të komunës sepse nuk kemi pasur hapësirë të mjaftueshme siç është edhe Drejtoria e Shëndetësisë me zyre në Qendren për Punë Sociale. E di që këto vajzat është mirë që t'i sitemojmë diku që të lirojnë Kryesuesin, ose të gjejmë një zyre më të mirë për të.

Mendoj që kur të planifikoni buxhetin për vitin e ardhshëm, renovimin e objektit të administratës të kompletuar ndani 200,000.00€ dhe e bëjmë planin bashkë dhe i rregullojmë të gjitha zyret dhe secila drejtori me pas sistemimin e punëtorëve mbranda saj.

Sa i përket zyreve të partive politike atje te Muzeu, zyret janë të lira dhe mund ta bëni. Vendoseni për atë.

Avdi Morina: Meqenëse u krijua një debat i panevojshëm dhe me të vërtetë që pajtohem me disa parafolës që kushtet për punë duhet të jenë sa më të mira, mirëpo mënyra se si grupet e opozidës po mundohen që çdo vendim me qëllime politike me prur në Kuvend duke u thirrur në arrogancën e votave, pa konsultime paraprake edhe me grupin tonë politik realisht është i papranueshëm për ne. Prandaj, mund të ketë ndonjë zgjidhje me një bashkëpunim në mes të Kryetarit dhe Kryesuesit që në të ardhmen e afërt që të sistemohet kryesuesi së bashku me stafin e tij. por, mënyrën se si jeni duke kotrabanduar vendime të tilla dhe më qëllime të caktuara, atëherë ne si grup nuk do të marrim pjesë fare votim dhe e ftoj grupin që të lëshoj sallën.
(NISMA lëshon sallën)

Rrahim Morina: Avdi, të lutem që të jesh më konstruktiv sepse ne jemi konsultuar për këtë çështje diku 5-6 herë me Kryetarin.
Në mugesë të kourrumit mbledhja mbyllet dhe mbledhja vazhdon të Premtën me dt. 07.09.2018 dhe fillon në ora 9:00.

Vazhdimi i pjesës së dytë i mbledhjes së rregulltë përfundo në ora 15:45.

* * *

Vazhdimi i tretë i mbledhjes së IX-të të rregulltë të Kuvendit të Komunë së Malishevës

Vazhdimi i mbledhjes mbahet me datë: 07.09.2018 dhe filloi në ora 09:20. Të pranishëm ishin në fillim të mbledhjes 25 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunal dhe media.

Rrahim Morina: Përshëndetje për gjithë të pranishmit në sallë! Sot është vazhdimi i mbledhjes së IX të rregullt. Kemi mbetë tek pika e 5-të e rendit të dites, debati është shterrë atë ditë ka mbetë vetëm votimi i kësaj pike. Po ju jap një informacion, dje kemi bisedu me Kryetarin kemi mbërritë një konsensus me Kryetarin rreth hapësirës së Zyres së Kryesuesit dhe grupeve politike. Është një zgjidhje e përkohëshme deri sa të renovohet objekti, zyrat e Drejtorisë së Financave të mbetet e Kuvendit. Deri atëherë Zyra e Kryesuesit do të jetë kjo që është tani për grupet parlamentare do të shfrytëzohen zyrat tek muzeu i qytetit si dhe në zyren e Shefqet Kryeziu do të barten Samirja me Marigonën ndërsa Shefqeti kalon në ndonjërn zyre të Drejtorisë së Arsimit.

Avdi Morina: Unë bisedova paraprakisht me Kryetarin dhe ai tha që jem marrë vesh që në projekt buxhetin e vitit 2019 ta fusim tek investimet edhe këtë çështje. Ai tha që nuk ka nevojë me nxjerr vendim, nëse ju doni me shku në këtë formë ne nuk e shohim të arsyeshme dhe ne nuk marrim pjesë në votim.

Alban Krasniqi: Nuk ka nevojë kurfarë investimi me bërë për grupet parlamentare në objektin e muzeut. Kryetari na tha që është i interesuar me kriju zgjidhje, ka fol edhe me kryesuesin. Për zyret e grupeve parlamentare kisha kërku që të merret vendim që menjëherë të rregullohen. Për pjesen tjetër nëse kryesuesi është pajtu që të futet në buxhetin e ardhshëm kjo është me vonesë.

Avdi Morina: Ne nuk jemi kundër që me ju kriju hapësira grupeve parlamentar por për hirë të korrektësisë grupi ynë do të abstenon.

Rrahim Morina: Kush jeni për?

Për: 22

Kuundër: 0

Abstenim: 4

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Dje ka vdek një i ri dhe ka qenë edhe anëtar i Qendres së rinisë Arsim Krasniqi sot bëhet varrimi në ora 15:00 kisha kërku mirëkuptimin e juaj që në ora 14:30 ta ndërprejmë seancen që të na mundësohet që të marrim pjesë në varrim.

Valon Krasniqi: Edhe grupi i LDK-së shpreh ngushëllime për familjen Krasniqi. Ne jemi që kjo pikë të diskutohet edhe pse nuk është Kryetari e drejtori. Në këtë raport po shihet që pothuajse në të gjitha digasteret ka shkelje të mëdha. Te ngarkesat tarifore sipas rregullore për taksa ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2017 përcaktohet tarifa për antarsimin vjetor në biblioteken e qytetit është 1€ për një vit. Ne pamë që në muajin janar-korrik ka pas tarifa vjetore të ndryshme 1€, 2€ dhe 3€. Te menagjimi i personelit në bazë të të gjeturave komuna nuk kishte arritur ende ti kompletoj dosjet në përputhjen e rregullores 03/2011. Edhe tek procedurat gjyqesore janë 8906euro dhe me këtë kam parë që në të gjitha dikasteret kem një qeverisje jo të mirë.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë. Edhe pse është bërë një raport mendoj që nuk është pasqyru e gjithë puna që është bërë në Komunen e Malishevës. Janë të theksuara 21 çështje si të gjetura. Në fillimi është thënë për një keq klasifikim të zërave buxhetor e që unë mendoj që është qëllimisht që të lënë mundesi për keqpërdorime. Menagjimi jo adekoat i dosjeve të personelit janë 16 punëtor me dosje të pa kompletuar. Menagjimi jo adekoat i të angazhuarve për shërbime të veqanta këtu duhet të punësohen joo më shumë së 6 muaj dhe duhen të jenë profesionist të fushave të caktuara. Furnizime me karburant është një kontatë më vlerë 90,000€ e që i bie kompania i fiton vetëm 90€ si mundet me furnizu një komunë me kaq pak fitim. Lidhja e

kontratës së transportit të nxënsave, subvencinet që jep kryetari, tek ndarja e bursave, ndërtimi i shtallave në të gjitha këto ka shkelje. Inicimi për procedurat e prokurimit pa planë ekzekutiv të ndërtimit kemi 3 raste të shkolla fillore në Llozicë, montim dhe servisim të nxemjes në disa shkolla në ndërtimin dhe asfaltimin në disa fshatra. Hyrja në obligime pa mbules buxhetore, ndarja e tenderve dhe planifikimi jo i plotë, pasojat e pagesave të vendimeve gjyqësor për shkak që komuna nuk i ka kryer pagesat me kohë dhe përshkak të ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënjëve së punës që ju ka bënë disa mësimdhënësve dhe punëtorëve të cilët nuk i kanë përkrahur politikisht për këtë gjë është dëmtuar buxheti mbi 93,000 kjo është për keq ardhje. Ka keqëklasifikime të shpenzimeve, dobësi në menagjimin e të hyrave dhe shpenzimeve, menagjii jo i duhur i funitorëve dhe dobësi i qeverisjes në përgjithsi.

Na kishim kërku që raporti për këtë vit të jetë pak më ndryshe i auditimit. Kjo do të varet shumë edhe nga qeveria komunale që udhëhiqet nga z. Begaj që të jetë më transparente më llogaridhëse.

Alban Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë. Auditori i ka paraqit disa shkelje, kurse në nga këto shkelje të evidentuara nga Auditori ne e krahasojmë me gjendjen në terren. Fillimisht do të them që për vini e kaluar janë 13 rekomandime që i ka dhënë auditori. Në vitin 2016 kanë qënë plus 12 rekomandime që gjithësej bëjnë 25. Nga ajo qka ka thënë auditori për 2016 një është realizu dhe 4 të tjera të cilat kanë fillu me u marr disa masa por ende nuk janë zbatu dhe 7 që janë tërsisht të pa zbatuara. I kemi 20 rekomandime që auditori i ka dhënë dhe që ende nuk janë zbatu. Ne kërkojmë që përmes një vendimi që deri në mbledhjen e ardhshme komuna të na jep një raport të detajuar mbi gjendjen e realizimit të rekomandimeve të dhënë nga auditori, dhe me na tregu se përse rekomandimet e vitit 2016 nuk janë realizuar asnjë fare. Kjo është kërkesë e imja. Raporti i auditorit aty është përdor gjuha më e butë që ka mujt me përdor. Kemi një qeverisje komunale injorante në aspektin e profesionalizmit. Në bazë të këtij raporti qeverisja Begaj na del të jetë një qeverisje e prapambetur dhe kjo mund të shihet lehtë në secilen zyre në secilin tender e konkurs, aplikim që e bënë si student si qytetar. Tek prokurimi i cili trajtohet si sektor që me letra e procedura gjysmake e keq menagjimin e paras publike. Raporti i Auditorit thekson se prokurimi nuk ka zbatuar ligjin për prokurim publik. Sot i vetmi ndryshim që vërehet në prokurim i cili vazhdon të udhëheqet përsos partika i Nismes pra prokurimi sillet rreth zyrtarëve të Nismes. Ka vërejte për tranzitin shpërkatjen e rrigrave, fushen e futbollit bile edhe për kontraten që thanë për punen e projektimit ka pas paknaqësi. Menagjimi jo adekoat i dosjeve të personelit, kur në një dosje të personelit kur nuk është dosja e aplikimit, kur nuk është cv e personit ajo automatikisht shkonë në hetim unë po du me thënë që ato vende pune ju kanë vjedh njerëzve duke anuluar konkurse deri sa keni shpall dhe derisa i keni lodh njerzit që janë detyru edhe me u tërheq. Çështja tjetër është qështja e prokurimit, planifikimit, menagjimit që raporti i auditorit i ka përmend. Kemi raste ku kemi pa që ka blerja me shuma minimale për me e përkthi në gjendje blerjet me shuma të tenderit janë lerje që tregojnë që nuk ka planifikim dhe ka blerje të koncentre. Rregullime të makinave shihet qart se sa kompani i ndërrojnë për çdo makinë. Procedurat janë të qarta, duhet me shpall tender për këtë punë dhe e merr kompania edhe kryhet.

Vendimet gjyqësore janë 42,000€ që paguan komuna në sektorin e arsimit kjo është si pasoj që padrejtësisht i kanë larguar punëtorët nga puna. Krejt në fund raporti i auditorit na tregon që herë do kurdo që ne ti drejtohem organëve të drejtësis sepse ne nuk do të presim përmirësime në keqmenaxhimin e paras publike kur i kemi 7 rekomandime të 2016 të pa kryera 13 rekomandime të 2017 që nuk janë respektu i kemi 7000-8000€ që ju kanë dhënë një kompanie biznesore private prapa të cilës qëndron baba i shefes së kabinetit të kryetarit.

Blerim Thaçi: Desha të flas pak a shumë me regimin e Albanit. Prej 2014 për dy vite sa kam qenë edhe tash asnjë shkelje personale ligjore nuk e kam bërë. Ato 42.000€ nuk e di të ciles pjesë i deklarove nëse jem duke fol për qështjen e inspektoriatit ato janë ra posht kanë qenë me tendens politike, nëse është për qështje gjoba se janë kthi punëtorë në punë po ju them me përgjegjesin më të madhe kemi mësues të pakualifikuar kemi mësues me shkollë të mesme kemi mësues që janë në procedura gjyqësore me diploma fallse, ka mësues me dy provime e që ka punu që 20 vite. Ky shtet nuk është duke menduar për fëmijë. Edhe tek qështja e drejtorëve edhe ajo është qështje politike.

Alban Krasniqi: Shumica e qështjeve gjyqësore janë humbur qëllimshëm nga komuna. Në kohën kur ka qenë Avdiu drejtor kemi kërku listen e krejt mësimdhënsave me përgatitje komplet që të bëhet publike. Nuk janë publike emrat e mësimdhënsave që sa ne i kemi kërku.

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë. E kam lexu raportin edhe më heret kur na është sjellë edhe tash e kam pa. Mendoj që kjo pjesa e zbatimit të rekomandimeve është më e rëndësishme edhe për administratë edhe për prokurim dhe për gjitha shpenzimet e paras publike edhe për menagjimin e projekteve. Auditori e ka bërë një punë që e bënë gjithëkund edhe është mësim i mirë po të merren rekomandimet e tyre. Auditori ish koncentru menagjimin e kontratave ku është thënë që disa fatura është dasht me qenë më të medhja se sa marrëveshja e tenderave. Disa nga rekomandimet e vitit 2017 e pash që janë shumica janë në projekt që kanë fillu për me u implementu mirëpo bazë finale nuk pash unë mendoj që deri i fund të vitit të gjitha rekomandimet kryetari i komunës do të vjen dhe të na thot që këto rekomandime janë zbatu ose janë në proces. Pash që mjetet financiare, borxhet e viteve të kaluara ka një rënje të mbledhjes së tyre unë mendoj që duhet të ngrihet një komision që ta ketë target mbledhjen e borgjeve të vjetruara që të hynë tek të hyrat. Dërsa komuna që ka borgje tek furnitorët ju e dini që ma vonë e kemi një qmim që quhet përmbarus edhe përveq atyre shpenzimeve që janë nëpër gjykatë ajo e merr edhe pjesën e vet. Unë nuk ju referohem rasteve individuale sepse edhe raporti është i përgjithshëm por unë mendoj që duhet të punohet shumë që këto rekomandime të zbatohen. U tha shumë që Nisma po punëson, unë për veti nuk e di asnjë as me emer e mbiemer se kush është punësu. Edhe njëherë po them rekomandimet e auditorit të zbatohen.

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë! Tek të gjeturat është një shumë prej 24 pagesave të testuar në vlerën 279,072€ ku përdorimi i tyre bëhet edhe për qëllime tjera që është në

kundërshtim me ligjin e buxhetit ku rrezikon të dështojnë edhe projektet. Në buxhetin e vitit të kaluar janë para 3 projekte në fshatin Astrazup ku njeri prej tyre është asfaltimi i rrugës Abdullah Morina që e bënë lidhjen Burim –Astazup. Nënkyetari ku është problem që kjo rrugë nuk kanë filluar procedurat?

Hidajete Mazreku: Përsëndetje nënkryetar, përsëndetje të pranishëm! Sa i përket auditorit ka shumë mangësi. Auditori i përgjithshëm shumë është mundu më na kursy sipas mendimit tim. Duke u nisur nga ajo që shumë punë janë bërë jo në rregull paramendoje ti nga njësia e auditimit të mbrendshëm që janë duke punuar njerzit në këtë njësi nuk e kanë parapar statutin. Kanë pas me i kontrollu 10 auditime vetëm 5 i kanë bërë. Unë e pyes nënkryetarin pse me urdhin e kryetarit janë bërë edhe dy auditime? Unë nuk e di në këtë njësi të auditimit sa vet janë të punësuar? Parafolsit e mi folen shumë rreth të gjeturave por unë në pika të shkurta. Është tek kontratat mbi veper tjetra tek kontratat e prokurimit. Duhet mi i cek ndërtimin e serave dhe ngritjen e shtallave kanë qenë 36 aplikues 16 i kanë plotësuar kriteret ku nuk dihen se si i kanë përzgjedh vetëm 10 persona. Tjetra tek iniciimi i procedurave prokurimit pa planë ekzekutiv të ndërtimit gjendja në obligime kontraktuse pa mbules buxhetore, shkolla në Llozicë edhe ujësjells në Pagarush mbi 474,521 nuk kemi mbules. Unë nuk jam kundër juve por jam kunder këtyre dobësive. Keni tek ndarja e tendereve dhe planifikimi jo i plotë i tyre, në 7 raste faturat e prokurimit nuk janë evidentuar në librin personal. Fatura e telefonis pse mos me u evidentu edhe kjo që ka borgj plus Ministria e Financave thot që as që na kanë treguar neve që janë të obliguar me ju tregu. E lus kryetarin që për 2018 auditori i mbrendshëm dhe njësi i tyre le të punojnë si duhet.

Ali Morina: Përsëndetje nënkryetar, drejtor, asambleist dhe ju të pranishëm! Unë desha ta plotësoj Arlindin e kam një pyetje, me 22 mars të vitit 2018 përveq rruges Abdullah Morina në Astrazup është parapa edhe rruga 15 maurantet që është mes lagjes Bataj, desha të dijë pse po zvarritet vazhdimisht kjo rrugë prej vitit në vit?

Rrahim Morina: Fillimisht e përsëndes nënkryetarin, drejtort komunal, gjithë të pranishmit! Shumë çështje u thanë nga parafolsit, po shihet që nuk ka digaster që nuk ka të gjetura, shkelje që i ka verifiku auditori. Niveli i ult i realizimit i të hyrave ne vitin 2017 janë ralizu vetëm 52 të hyra vetanake që është një shifer shumë e ulët. Menaxhimi jo adekuat i dosjeve u thanë, është mirë kjo qështje të përmirësohet. Angazhimi jo i mirë me kontrata të veçanta nga 46 të angazhuarit që faktikisht ligji jep të drejt për 6 muaj por jo më shumë se kaq por tjetra është se ligji e sheh edhe një konkurs. Mangësi me furnizimin me derivate, unë po pajtoj me atë që e that që komapania më e lirë e merr por prej 90,000€ po i fitojka 92€ le ta merr më i liri por le të menagjohet dhe kontrollohet nga organet përkatëse komunale. Tjetra lidhja e kontratave pa procedur të prokurimit, 23,285€ është vlere për bartjen e nxënsave kjo është shkelje flagrante të ligjit që bëhet. Tek suvencionet shumë kjo thot edhe ligji që kryetari ka të drejt me nda vleren deri në 1000€ mbi këtë shumë atëherë kuvendi komunal e bënë ndarjen. Në këtë rast kryetari ka

nda subvencione ndaj Shoqates së Biznesit në Malishevë në vler 7600€ dhe kjo është një shkelje. Te vendimet gjyqësore kemi fol vazhdimish për mendim timin është shumë e pa arsyshme 93,000€ me nda për denimet e vendimeve të gjykatave, kjo më mirë ka qenë me shku në ndonjë projekt se sa me i pagu keto denime. Po ndalem tek rekomandimet nga 25 rekomandime 14 as që janë shqyrtuar fare.

Hajdin Berisha: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për ju asambleist! Në momentin kur e kemi pranuar raportin e auditorit e kemi shqyrtuar komplet dhe jemi duke u marr seriozisht me këtë raport dhe besoj që të gjitha rekomandimet që na janë dhënë do ti shqyrtojmë të gjitha.

Rrahim Morina: Kemi një propozim nga Alban Krasniqi, kërkon nga kryetari që ta sjellë raportin me shkrim për mbledhjen e ardhshme me na tregu për të gjitha rekomandimet që i ka dhënë auditori dhe na me pa se si është duke shkuar realizimi ose zbatimi i rekomandimeve e kjo të sillet në mbledhjen e tetorit. Kush jeni për?

Për: 21

Kundër: 1

Abstenim: 3

Sipas radhës kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë. Kemi vendimin për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave të banorëve të lagjes Mirdita në Malishevë ku ky komision do të jetë në përbërje prej 7 anëtarve. Nga kuvendi do të jenë 4 anëtar dhe 3 anëtar nga ekzekutivi i komunës. Nëse ka mundësi me na i jap 3 emra qeveria komunale dhe po ashtu edhe grupet parlamentare.

Valon Krasniqi: Grupi ynë propozon Arlind Morina.

Alban Mazreku: Grupi jonë i PDK-së propozon Kastriot Berisha dhe Hamëz Bytyqi.

Avdi Morina: Grupi ynë propozon Filoreta Bytyqi dhe Abetare Limaj.

Alban Krasniqi: Vendimin kur e kemi marr ka qenë që 3 muaj me pas mandat ky komision. Ka dy muaj që ne kemi fomu por që i bije që veq edhe një muaj me funksionu e ne sot i propozojm emrat. Grupi jonë qysh edhe në fillim është tërhek por tëhiqemi edhe sot deri në momentin që ulemi dhe i trajtojmë qështjet me seriozitet. Gati i kemi 3 muaj, të mos tallemi sepse njerzit atje e kanë statusin e pa zgjidhur. Nëse vazhdohet kështu në nuk do të votojm si shej revolte në trajtimin e rastit. Veq edhe 1 muaj e keni afat në bazë të vendimit që kemi marr.

Avdi Morina: Unë po e shoh më shumë si politike me lu me fatin e njerzëve që realisht kanë strehim atje dhe që fatkeqësisht strehimin e tyre e rregullon edhe ligji. Nuk është fare problem veq a punohet se qysh këtu ja japim edhe 3 muaj mandat. Në si grup parlamentar jemi që të ja japim edhe 3 muaj mandat.

Alban Krasniqi: LVV merr pjesë nëse në komision përfshihet edhe përfaqësuesi i kërtyre shfrytëzueshve të banesave. Nga kuvendi munden me qënë 4, 2 nga ekzekutivi 1 përfaqësuesi i përfaqësuesve të kërkesës.

Rrahim Morina: A po pajtohuni edhe me një çështje, meqë ka mbetë që ekzekutivi me i sjellë emrat a e shtyjmë për mbledhjen tjetër edhe vijn emrat nga kryetari?

Alban Mazreku: Është mirë më i votu ata emra që sjellen, kuvendi i japi emrat dhe komisioni mundet me funksionu edhe me 4 anëtarë.

Kastriot Berisha: Pajtoj me Alban Krasniqin që 4 të jenë nga kuvendi, 2 nga kryetari dhe 1 nga përfaqësuesit e banorëve të atyre banesave. Nëse nuk i bjenë kryetari komisioni mundt me vazhdu punen me ata anëtar.

Muharrem Morina: Forma e ndryshimeve të vendimeve ne anen procedurale ligji e ka të specifikuar por duhet ta keni parasysh se ky vendim është qertifiku edhe në MAPL. Është më mirë me shty për mbledhjen e radhes hyn si pikë emërtimi i anëtarit të ri.

Arbëreshë Krasniqi: Për neve nuk është problem veq me marr pjesë. Në emër të grupit ato dy propozime po jua lëjm juve zgjidhni dhe po e lus nënkryetarin që ti sjellë emrat. Nuk e kemi ne problemit a po përfaqësohemi ne port e zgjidhet situatë.

Rrahim Morina: A po pajtoheni që 2 t'i ketë PDK, 1 LDK dhe 1 LVV. Mirë atëherë shkojmë në pauzë për 5 min, konsultohemi e kthehemi.
Ne u kthjem pas asnjë qëndrim por që ka propozime. Kjo është një çështje shumë delikate dhe e ndjeshme. Është mirë të përfshihen të gjitha subjektet dhe të gjitha strukturat që të mbërrimë deri në një vedim që do t'i knaqë interesat e tyre që banojnë aty dhe të në anën tjetër të respektohet ligji.

Alban Mazreku: Ne propozojmë dhe në emër të LDK-së që të thehet vendimi i dt: 13.07.2018 i marrur nga Kuvendi Komunal në Malishevë dhe të nxjerret një vendim i ri dhe në këtë komisioni përbërja të jetë nga një anëtar i çdo grupi politik, 2 përfaqësues të jenë nga Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe 1 përfaqësues të jetë nga lagjia "Mirëdita" që e kanë bërë këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: Një plotësim. Në këtë rast të shtyhet afati deri në fund të vitit dhe në mbledhjen e dhjetorit ky komision duhe të raportojë.

Rrahim Morina: Së pari duhet të votojmë për shfuqizimin e vendimit të datës 13.07.2018 e pastaj e hudhim në votim propozimin e Alban Mazrekut.
Kush është pro analimit të vendimit të dastës 13.07.2018?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me këtë votim shfuqizohet vendimi i datës 13.07.2018 i Kuvendit Komunal të Malishevës. Atëherë shkojmë me propozimin e Albanit Mazrekut dhe i LDK-së që propozoi që 2 përfaqësues të jenë të Kryetarit, një të jetë nga 32 familjet që kanë bërë kërkesë dhe nga 1 përfaqësues nga të gjitha grupet politike që janë këtu. Kush është për?

Për: 20

Kundër: 1

Abstenim: 3

Me këtë votim aprovohet propozimi i PDK-së, LDK-së dhe VV-jes. Tani është koha që të propozoni ju grupet politike këtu anëtarët për këtë komision. Ndërsa Kryetari anëtarët e vet i sjellë në një mbledhje tjetër.

Sylë Dukolli: Ne propozojmë Abetare Limaj si anëtare në këtë komision.

Rrahim Morina: NISMA propozoi Abetare Limaj, kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me këtë votim Abetare Limaj është anëtare e këtij Komisioni.

Alban Mazreku: Ne për këtë Komision propozojmë Kastrito Berisha.

Rrahim Morina: Kush është që Kastriot Berisha të jetë anëtar në Komisionin për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim Kastriot Berisha zgjedhet anëtar për këtë Komision.

Valon Krasniqi: Ne LDK-ja propozojmë Arlind Morina.

Rrahim Morina: Kush është për që Arlind Morina të jetë anëtar në Komisionin për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim Arlind Morina zgjedhet anëtar i këtij Komisioni.

Hidajete Mazreku: Ne propozojmë Alban Krasniqin për këtë Komision.

Rrahim Morina: Kush është për që Alban Krasniqi të jetë anëtar i Komisionit për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me këtë votim Alban Krasniqi zgjedhet anëtar për këtë komisioni.

Atëherë kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1228 datë: 22.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për themelimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës. E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Hajdin Berisha: Kërkesa e Kryetarit që është sjellur këtu por është hequr disa herë nga rendi i ditës dhe ka të bëjë me Inkubatorin e biznesit. Kryetari është në Prishtinë dhe është duke nënshkruar dy marrëveshje të finacimit të projekteve shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me Komunën e Malishevës. Fjala është për finacimin e kanalizimit nga Lladroci deri në Malishevë në gjatësi prej 9 km. Projekti tjetër është për shtratin e lumit në Malishevë për të cilin kemi diskutuar edhe këtu në Kuvend.

Kërkesa e Kryetarit ka të bëjë vetëm me vendim për themelimin e Inkubatorit të biznesit. Pasi të marrim vendimin në Asamblesë Komonale procedurat tjera duhe të kryhen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë sepse investimi vjen nga kjo ministri. Të gjitha arsyeshmëritë ekonomike, lokacionin duhet t'u paraprijë vendimi i Asamblesë sepse procedurat tjera do të kryhen më vonë. Në emër të Kryetarit kërkoj që ky vendim duhet të miratohet.

Avdi Morina: Nën kryetari e sqaroi kërkesën që ka ardhur nga Kryetari. Ne grupi ynë e mbështesim këtë kërkesë e cila do të jetë në të mirën e biznesit në Malishevë. Çdo investim që vjen për të mirën e qytetarëve të Malishevës do ta kisha përkrahur sikur të isha edhe në opozitë, andaj kërkoj nga ju që ta përkrahni këtë kërkesë sepse është për të mirën e Malishevës.

Alban Mazreku: Në këtë kërkesë e kemi edhe disa dokumente të bashkëngjitura, por është vetëm një lëndë e që është nga drejtori i Urbanizmit që u është drejtuar KPP-së. Këtu e kemi një fotografi se si do të doket ky Inkubator. Nën kryetari tha që e kemi projektin të detajuar, por ne nuk e kemi këtu. Ne gjithashtu e kemi një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Komunës së Malishevës e që është e nënshkruar në vitin 2016. Në fund i kemi fletat poseduese, mirëpo ato që kemi kërkuar si grup arsyeshmërinë ekonomike të Inkubatorit. Kush do ta administrojë Inkubatorin?

Nëse themelohet Inkubatori kërkojmë që çdo subjekt politik të përfaqësohet si pjesë e Komisionit për Përzgjedhjen e Bizneseve. Kush do t'i përpilojë çmimet për qera që do t'i paguajnë bizneset?

Kërkojmë që Inkubatori të jetë asetë i Komunës dhe të menaxhohet nga qeveria komunale së bashku me Kuvendin e Komunës.

Valon Krasniqi: Ne grupi ynë kemi qenë pro investimeve kapitale sikur atëherë në mandatin e kualuar ku Lutfi Zharku ka investuar në disa rrugë, në shtëpinë e kulturës, stadiumi i qytetit etj. Por sa i përket Inkubatorit në Malishevë jemi kundër sepse hapësira është në kontekst gjyqësor. Pa u sqaruar situata nuk mund të kemi diçka konkrete, por nuk jemi kundër investimeve në Malishevë.

Neve na duhen dokumente shtesë për këtë çështje dhe nëse është gjithëçka në rregull në një të ardhme të afërt edhe grupi ynë do ta mbështesë.

Alban Krasniqi: Me kaq pak dokumente kërkoj nga kolegët asamblesistë që ta themelojmë një qendër kërkimore, hulumtuese dhe shkencore të quajtur "NASA Kosova" informacionet do t'i gjeni diku, e rëndësishme ta themelojmë diku e masandej flasim. Kështu po e kërkon ju të bëni Inkubatorin, kaq serioz jeni.

Ne në dy mbledhje të KPF-së e kemi diskutuar këtë çështje dhe në atë të fundit e kam shqyer kërkesën në shenjë paknaqësie dhe revolte në trajtimin e çështjeve që janë kaq të rëndësishme. Nëse Inkubatori i biznesit është çështje e rëndësishme për K. e Malishevës, ata e dinë që Kuvendi e merr vendimin. Nëse Kuvendi e merr vendimin atëherë çka duhet me ju ofru këtyre njerëzve, cili është informacioni i të dhënave. Informacionet janë asgjë prej gjëje. Kjo është fyese për ne si kërkesë, sepse po kërtoni të votojmë për një gjë që nuk e dimë se çka është dhe as që keni nevojë me ditë se çka është.

Nënkryetarit thotë që ta themelojmë, ndërsa kërkesa është të ndahet vendi është diçka që po na vëni në lajthitje. Pa u diskutuar në detaje se cili është qëllimi i këtij Inkubatori që është 249,480.00€ sipas projekt-buxhetit për 6-mujorin e parë të këtij viti.

Ne kemi hapësira të shumëta, të cilat ne nuk e dimë se kush i shfrytëzon sot siç është tek qendra "Dardania" që do të mund të shfrytëzohej për këtë qëllim. Pra, mos të deridhim mjetë për të zaptuar më shumë hapësirën publike e që mbrenda saj e ka ende një paqartësi.

Prona që po kërkohet i takon Stacionit të Autobusëve dhe ky trajtim i ulët që po i bëhet këtij aseti publik sepse po i nxihet stacionit një hapësirë kaq e madhe, e cili është fati i stacionit nesër?

Nuk është turp të tregoni që po ja bëni Dautit këtë punë dhe asaj vajzës së shoqiatës "Malasi".

Mos prisni gaditshmërinë tonë që të përkrahim projekte që tani ju dihet destinimi. Unë kërkoj që mos të përkrahet dhe të votohet kjo çështje pa e sosur edhe pikën e fundit të informacionit, sepse pasojat mandej i vuajmë ne. Ne kemi nevojë për Inkubator të Bujqësisë, kemi nevojë për përkrahje të fermerëve dhe bujqëve, jo për një Inkubator të tillë.

Kërkoj që kjo kërkesë të kthehet në KPF, e ftoj të marrë pjesë edhe NISMA, t'i ftojme bizneset dhe të shohim se çka do të përfitojmë me këtë punë. Përndryshe po kërkon për të themeluar diçka që nuk jeni në gjendje për t'na treguar se çka është.

Sylë Dukolli: Ky Inkubator është në të mirën e qytetarëve të K. së Malishevës. Mendoj që këto mjete nuk janë nda prej Kuvendit Komunal të Malishevës, por nga niveli qendror. Ky Inkubator është një adresë e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare që të bashkëpunojnë për çështje investive që do të themelohet. Ne e falemnderojmë MTI-inë për këtë investim dhe arsyeshmërinë ekonomike do ta arrijë në kohën kur do të lidhen shumë kontrata biznesore të ndërmarrjeve të mbrendshme dhe të jashtme.

Përveç fjalëve që po fliten këtu t'ju çojmë një mesazh të mirë qytetarëve të Malishevës se më në fund diçka e mirë po vendoset nga kjo mbledhje maratonike që po zgjat. Është fat që na është dhënë kjo mundësi që të themelohet ky Inkubator i bizneseve.

Kastriot Berisha: Dokumentacioni që kanë sjellë për këtë Inkubator është pak i mangët, ndërsa në anën tjetër është investim pozitiv sepse është mirë që të investohet vlera 250,000.00€ se sa t'i humbasim.

Unë jam i njoftuar që prona është në kontekst gjyqësor dhe këtë duhet ta dinë më mirë personat zyrtarë se a kanë të drejtë që të ndërtojnë apo jo.

Unë personalisht, jo në emër të grupit, jam pro çdo investimi që bëhet në K. e Malishevës pa marrë parasysh a është inkubator, shkollë apo diçka tjetër.

Unë jam kunder Alban Krasniqit dhe Alban Mazrekut më mirë është që këto para të investohen në Malishevë sepse mund të punësohen aty njerëz sa sa të humbim investimin.

Alban Krasniqi: E para, buxheti i Kosovës është buxhet i yni kjo logjikë se humbet investimi në Malishevë, po ai investim shkon diku tjetër në Kosovë, jo në Serbi. Kjo logjikë e ka dëmtuar këtë

vend. Janë koncetrui investimet në një vend e janë lënë anash vendet tjera, unë jam kundër kësaj logjike. Nëse vazhdohet me këtë logjikë, kanë për t'na parë sherrin edhe fëmijët tanë.

Hidajete Mazreku: Këtë kërkesë po më vjen çudi se pse KPF-ja nuk e ka ndaluar, ajo është dashtë t'a ndalojë duke pasur parasysh dokumentet e pakëta që janë sjellë. Kur kam dëgjuar për fjalën inkubator kam menduar që është fjala për ndonjë frigo për mbrojtjen dhe ruajtjen të produkteve bujqësore. Qeveria ka subvecionuar shumë biznese bujqësore e sot ato prodhime po kalben.

Një guti të tillë e keni pasur edhe për Qendren e Bizneseve dhe e dimë të gjithë se si është krijuar. E dimë që aty janë punësuar disa njerëz politik dhe krijuan një zyre të vogël të bizneseve. Çfarë kërtime operationale në lidhje me bizneset janë bërë? Çfarë zhvillime të ideve të reja për bizneset janë bërë aty? Thuani ju Nënkrjetar që Qendera e Biznesit ka dalur me një plan veprimi konkret që ky biznes është adekuat për Malishevën. Aty janë grumbulluar në një zyre të gjithë të punësuarit për këtë çështje dhe në atë ndërtesë janë vendosur zyrtarë komunal. Kjo Qender e Bizneseve a ka anëtarë dhe a paguajnë për anëtarim bizneset? Nuk e di?!

Nuk jam kundër që të ndërtohet ky inkubator, por jam kundër që aty njerëz nuk mund të veperohet sepse prona është në kontest gjyqësor. Kjo parcelë 507-1 nuk është as e Kosovatransit, kjo kërkesë kryekput është orientuar në këtë pronë e që është ndarë në 2-3 parcela. Për këtë parcelë është marr vendimi 03.11.2015 i datës që shpallet zonë e interesit të përgjithshëm diku për 2 hektarë e 813 ari.

Kam një pyetje për drejtorin e Kadastrës. Si erdhën në përfundim që këtë parcelë me nda që janë marrë vendime? Kryetari u mburrke me këto parcela që do të ndërtohet shkolla, e tash na bie si pluhur në sy me kontratën me Kosovatransin. Cilat prona menaxhohen nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit? Kjo kërkesë bie në kundërshtim me çështjet që përmenda e ju po mendoni që nuk e dimë se çka votojmë. Ju lutem kolegë asambleistë, mos votoni gjëra që nuk na përkasin neve!

Kastriot Berisha: Unë jam pro që të vijnë 250,000.00€ investim nga Ministria. Parafolësit e mi që thanë që paraa të shkojë edhe në një komunë tjetër, mund të shkojë, por unë jam i votuar nga qytetarët e Malishevës dhe jam i thirrur për këtë komunë.

Halil Morina: Përsëritet për të gjithë! Komuna jonë është njëra ndër komunat më të varfëra në Kosovë. E vetmja mënyrë për të zhvilluar këtë vend është zhvillimi i sektorit privat, përkatësisht bizneset.

E di që këta inkubatorë në tërë botën funksionojnë si laborator të ideve të reja për biznes. Këto ide me asistencën e këtij laboratorit kthehen në sipërmarrje. Sipërmarrja gjeneron vende të reja të punës. Prandaj, unë e konsideroj këtë inkubator shumë të rëndësishëm dhe të shumëanshëm për bizneset dhe pres që të gjithë do ta votoni.

Unë nuk kam paranoja, por i kuptoj paranojat e dikujt. Këto paranoja janë deritvacion i orientimit të tyre ideologjik. Zakonisht partitë ekstreme të majta janë identifikuar me këso paranoja e skepticizma qoftë në raportin e jashtëm, qoftë në atë të brendshëm. Ata mendojnë që këtu diçka është duke u zier. Po, në fakt është duke i ardhur era përpjekje e zhvillimit ekonomik të kësaj komune të varfër.

Hajdin Berisha: Falemnderit për debatin që e bëtë rreth kësaj pike që ne e kemi konsideruar të rëndësishme prandaj po kërkojmë miratimin e juaj për themelimin e Inkubatorit të Biznesit.

Është një ndër kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.15/2016 të MTI-së mënyra e themelimit të inkubatorit të biznesit. Aty janë dy mënyra. Mënyra që neve na intereson është kur komuna është inicuese e themelimit të Inkubatorit të Biznesit. Është kryer projekti, është përcaktuar lokacioni te Stacioni i Autobusëve që të bëhet ndërtimi i këtij inkubatori. Për më shuëm se ju kam njohuri rreth asaj prone jam fajtor në kuptimin pozitiv që ajo pronë ka mbetur pa u privatizuar, po flas edhe për stacione tjera, jo vetëm të Malishevës. Sot Stacioni i Autobusëve është Ndërmarrje Publike Komunale me 100% të aksioneve nga komuna. Asnjë vendim ose aktgjyjm rreth pronës së Stacionit të Autobusëve nuk ka të cilën kishte për ta obliguar komunën që të heq dorë nga ajo. Kurdo që palët kanë ndonjë vendim të plotëfuqishëm atëherë komuna do ta marrë në rishqyrtim.

Pasi të marrim vendimin për themelimin e Inkubatorit të Biznesit ne duhet t'ju drejtohem MTI-së me një aplikacion për t'na miratuar. Besoj që miratohet një miratim i tillë dhe vjen të bordi sepse udhëzimi administrativ e përcakton qartë se kush ë përbënë bordin e Inkubatorit të Biznesit. Aty anëtar i bordit do të jetë edhe përfaqësuesi i MTI-së. Unë kërkoj nga ju që ta votoni dhe të ecim me procedurat e mëtutjeshme.

Rrahim Morina: Nëse nuk ka debat po e hedhi në votim kërkesën nr.01/1228 datë: 22.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për themelimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës. Por në këtë kërkesë është edhe ndarja e parcelës. Janë edhe dy parcela 506-1 dhe 507-1. Kush është pro aprovimit të kësaj kërkesë?

Për: 15

Kundër: 11

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovet kërkesa nr.01/1228 datë: 22.08.2018 të parashtruar nga Kryetari i Komunës për themelimin e Inkubatorit të Biznesit të Komunës së Malishevës.

Alban Krasniqi: Këtë vendim që e keni marrur me 15 vota, shikojeni a duhet të jetë me 16 sepse me dijen time, pronat duhet të jepen me 16 vota.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues, ka mundësi që mbas pauzës të mos jem këtu. Ju falemnderoj për mbështetjen e kësaj pike dhe për projektin që po vjen për Malishevën dhe njëkohësisht ju zotohem që Arbëresha so të punojë ndershmë dhe mirë dhe do ta kem fokusin që të zhvillohet Kosova në përgjithësi, e në veçanti për Malishevën!

Rrahim Morina: Shkojmë në pauzë për 30 minuta, pra kthehem në ora 13:15.

Pas pauzës së drekës, unë e kam një propozim, në ora 14:30 të ndërprejmë mbledhjen me vazhdu për në varrim dhe t'i shqyrtojm vetëm pikat që kërkojnë miratim. Mirë.

Atëherë kalojmë në pikën e rendit të ditës që këkon vetëm miratim: Plani i veprimit i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Rrahim Morina: Kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenime: 1

Kalojmë në pikën e 17-të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/244 datë:29.06.2018 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme për

vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-807/6 datë:16.07.2018. E ftoj Muharremin që t'na sqaroj çështjen ligjore.

Muharrem Morina: Lidhur me dy vendimet e asambles dhënies në shfrytëzim e pronës publike për billborde edhe për KEDS-in në Tërpez. Të dy vendimet MAPL-ja i ka kthyer dhe ka thënë që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi ata konsiderojnë që prona nuk është pronë e kuvendit komunal dhe kuvendi nuk ka të drejtë me dhënë pronën në shfrytëzim.

Rajmonda Krasniqi: Për herë të parë në mbledhjen e KPF-së në mbledhjen e muajit qershor kërkesa e kryetarit të komunës për dhënen në shfrytëzim vendin të quajtur Shpatira. Kërkesa e parë kur ka ardh nga kryetari lexon drejtoria për gjeodezi dhe kadastrë komuna Gllogoc, pra është pikërisht Komuna e Drenasit, këtu i kanë rënë vi dhe me stilograf e kanë shënuar Komuna Malishevë dhe kjo tregonë që është komplet e jashtë ligjshme normalisht sepse pjesa i takonë komunës së Drenasit. Të dy anëtarët e PDK-së që jemi në KPF kemi qenë kundër kësaj kërkesë për shkak shkeljeve ligjore. Edhe si krup parlamentar këtu në asamble kemi qenë kundër kësaj kërkesë. Në KPF nuk e kemi rekomanduar për kuvend dhe nuk e di se si kryesuesi e ka sjell këtë kërkesë.

Bashkim Krasniqi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Sëpari kërkesën e ka bërë disiti i shpërndarjes nga Prishtina ku e përfshinë edhe Terpezën këtë kërkesë e ka bërë në kuvendin komunal ju ka drejtuar Drejtorisë së Pronës Kadastrës dhe Gjeodezisë. E kanë shënuar vet gabimisht Gllogoc i kanë rënë vet më vi e kanë bërë pastaj Malishevë, kjo është shkresë e tyre. Është edhe e protokoluar. Vendi ku ata e kërkojnë është vend katastral Tërpez dhe është pronë e Tërpezës. Ai duhet me kërku leje që me dhënë në shfrytëzim nga Komuna që planifikon me vendos trafektin për me rrit kapacitetin e rrymës.

Muharrem Morina: Nëse ne nuk e shfuqizojmë ashtu siq po e kërkon ministria ata na padisin dhe ne jemi pal paditëse në gjykatë.

Ali Morina: Në emrin e grupit kërkojmë shfuqizimin e kësaj pike pastaj e shohim vendimin.

Rrahim Morina: A po pajtoheni që ta kthejmë edhe njëherë në rishqyrtim konfirmimin e MAPL-së për billborda? Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenime: 0

Kalojmë në pikën e 18-të të rendit të ditë: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/274 datë:13.07.2018 për dhënen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale KEDS-it në fshatin Terpezë për qëllime të infrastrukturës energjetike, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-860/1 datë: 20.07.2018.

MAPL-ja e ka kthyer vendimin me të vetmin arsyetim që komuna nuk është pronare dhe nuk mund ta jep në shfrytëzim token e huaj. PDK-ja po kërkon me anulim vendimin. Po e hudh në votim të

parën. Kush është që të rishqyrtohet konfirmimin i MAPL-së me qu në rishqyrtim. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 6

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, përkatësisht të 19-ën: Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për caktimin e javës së Diasporës.

Komiteti për Diasporë ka mbajtur një mbledhje dhe ka nxjerrë një rekomandim që Java e Diasporës të jetë tradicionale dhe të filloj nga data 25 korrik dhe të përfundojë me datën 2 gusht.

Alban Krasniqi: Komiteti për Diasporë, po sa për informacion kjo ka rrjedh prej Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport por edhe qytetarëve që janë angazhu por edhe në KPF është diskutu dhe dakordu që jetë një javë e diasporës. Veç po du me i shtu dy gjëra, e para në kuadër të kësaj është mirë të përfshihet edhe "Oda e Llapushës" një aktivitet i cili shtë ka bëhet por nuk ka bazë prej Kuvendit. E dyta, pse sot me vendos për këtë. Unë jam që në vendim me caktu Komiteti për Diasporë dhe Komiteti për Arsim që bashkarisht me ardh me disa pika të cilat prap kuvendi pasandej i aprovon si pika bazike që janë brenda kësaj jave, pra me ja lënë këtyre dy komiteteve se si e mendojnë me qënë Java e Diasporës.

Rrahim Morina: A po pajtoheni që Komiteti i Diasporës bashkë me Komitetin e Arsimit edhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ta precizojnë duke e përfshirë edhe Oden e Llapushës.

Kush është për?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenime: 2

Hajdin Berisha: Desha të ju jap një informacion, nesër zyrtarisht fillojnë punimet lloton e 3 të tranzitit. Në ora 12:00 është ceremonia e përrurimit të punimeve gjithë jeni të mirëseardhur ju mirëpresim.

Rrahim Morina: Ju faleminderit për pjesëmarrje! Me kaq këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Shihemi në mbledhje tjera!

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

